



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology

## Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

### UDHËZIM ADMINISTRATIV

#### Zbatimi i standardeve për tekstet shkollore

NUMËR: 5/2011

Datë: 31.08.2011

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet; 4, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcën 6 dhe neni 33.2 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 22.03.2011, neni 4 paragrafi 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr UA:

#### Neni 1 Qëllimi

Ky udhëzim administrativ përcakton zbatimin e standardeve për tekstet shkollore.

#### Neni 2 Standardet për tekstet shkollore

Pjesë e këtij udhëzimi administrativ është dokumenti “Standardet për tekstet shkollore”.

#### Neni 3 Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri.

  
Prof. dr. Ramë Buja, ministër





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada – Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstva Obrazovanja Nauke i  
Tehnologije -Ministry of Education Science &Technology*

# **Standarde për tekstet shkollore**

Prishtinë,2011

Ky dokument përmban standarde të përgjithshme dhe të veçanta, sipas lëndëve apo fushave lëndore, për vlerësimin e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar. Dokumenti është konceptuar si mjet ndihmës për dorën e ekspertëve në këtë lëmë (specialistë/e të arsimit e të administratës, përfaqësues/e të shtëpive botuese të teksteve shkollore, autorë/e të teksteve shkollore). Atyre ai u vë në dispozicion një spektër të gjerë e të gjithanshëm të kriterëve relevante, me rëndësi për vlerësim, si dhe një mjet vlerësimi praktik dhe të përdorshëm.

Iniciativën për krijimin e dokumentit e mori Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës; realizimi i saj është bërë nga një grup pune i përbashkët nga Kosova dhe Zvicra.

**Në financimin dhe realizimin e këtij projekti kanë kontribuar:**

Shkolla e Lartë Pedagogjike e kantonit të Cyrihut (Zvicër)/  
Instituti IPE (International Projects in Education)

  
pädagogische hochschule zürich

Lotteriefonds des Kantons Zürich

**LOTTERIEFONDS  
KANTON ZÜRICH**

# Përmbajtja

## Hyrje

1. Pikënisja, sfondi	5
2. Përshkrim i shkurtër i standardeve dhe i treguesve; procedura e miratimit	5
3. Sqarime terminologjike	
4. Qëllimet dhe funksionet e standardeve	6
5. Udhëzime për punën konkrete me standardet	7
6. Objektiviteti	8
7. Sfonde dhe burime të mbledhjes së standardeve; çështje tipologjike	8

## A) Standarde të përgjithshme

### I) Aspekte formale; paraqitja dhe pamja etj. (standardet 1 – 3)

1. Përputhshmëria me kurrikulin dhe me tekstet shkollore të së njëjtës lëndë të klasave pararendëse dhe pasuese (1.1 – 1.3)	12
2. Paraqitja, pamja, qartësia (2.1 – 2.5)	13
3. Ilustrimet (3.1 – 3.4)	14

### II) Aspekte metodike dhe didaktike (standardet 4 – 8)

4. Cilësia, relevanca dhe aktualiteti në pikëpamje përmbajtësore dhe shkencore (4.1 – 4.4)	15
5. Përshtatshmëria me moshën e nxënësve/eve (5.1 – 5.4)	16
6. Përpunimi dhe përpilimi didaktik (6.1 – 6.13)	17
7. Pyetjet dhe detyrat (7.1 – 7.5)	19
8. Aspektet gjuhësore (8.1 – 8.6)	20

### III) Aspekte pedagogjike (standardet 9 – 12)

9. Lidhjet me realitetin shoqëror, historik dhe politik (9.1 – 9.4)	21
10. Lidhjet me aspektet Edukim për pjekuri/pavarësi; Edukim për demokraci; Edukim paqësor (10.1 – 10.4)	22
11. Reflektimi i barazisë gjinore (angl.: gender-education) (11.1 – 11.6)	24
12. Përmbajtje ndërkurrikulare të tjera të rëndësishme (12.1 – 12.4)	25

### IV) Aspekte të praktikës pedagogjike (standardet 13 – 15)

13. Doracak për mësimdhënësit/et; përdorueshmëria e tij (13.1 – 13.5)	26
14. Materiale pune (ushtrime etj.) në lidhje me tekstin shkollor (14.1 – 14.3)	27
15. Sprovimi/testimi praktik, paraprak, i tekstit shkollor (15.1 – 15.2)	28

## B) Standarde plotësuese sipas lëndëve

16.1 Gjuha amtare (gjuha në të cilën jepet mësimi në pjesën përkatëse të vendit)	29
16.1.1 Abetarja (16.1.1.1 – 16.1.1.17)	29
16.1.2 Libri i leximit (16.1.2.1 – 16.1.2.16)	32
16.1.3 Libri i gjuhës (për gjuhën amtare; gramatikë etj.) (16.1.3.1 – 16.1.3.15)	35
16.2 Gjuhët e huaja (16.2.1 – 16.2.20)	38
16.3 Gjuha shqipe për komunitetet joshqiptare (16.3.1 – 16.3.15)	40
16.4 Matematika (16.3.1 – 16.3.20, përkatësisht 16.3.1 – 16.3.24)	42

16.5 Shkencat e natyrës (Njeriu dhe Natyra në klasat 1-5; biologji; fizikë; kimi; astronomi, gjeografi në nivelin e dytë; plus lëndë me zgjedhje nga fushat përkatëse) (16.5.1 – 16.5.20, përkatësisht 16.5.1 – 16.5.24)	46
16.6 Shkencat shoqërore	
16.6.1 Historia (16.6.1.1 – 16.6.1.15)	49
16.6.2 Edukata qytetare (16.6.2.1 – 16.6.2.13)	51
16.6.3 Shkencat e tjera shoqërore (psikologji; sociologji; filozofi; logjikë; ekonomi; gjeografi në nivelin e parë; plus lëndë me zgjedhje nga fushat përkatëse) (16.6.3.1 – 16.6.3.16)	53
16.7 Edukata muzikore (16.7.1 – 16.7.16)	55
16.8 Edukata figurative/Arti figurativ (16.8.1 – 16.8.15)	
16.9 Punë dore (vetëm klasat 1-5) (16.9.1 – 16.9.15)	
16.10 Teknologjia me informatikë (TIK) (16.10.1 – 16.10.22)	
16.11 Edukata fizike dhe sportive (16.11.1 – 16.11.11 )	
16.12 Materiale didaktike për nivelin parashkollor (16.12.1 – 16.12.17)	
16.13 Tekste shkollore për profesione të ndryshme në shkollat profesionale (16.13.1 – 16.13.22)	
16.14 Tekste shkollore për diasporën (16.14.1 – 16.14.19)	

**Formular përmbledhës:** Vështrim i përgjithshëm, përmbledhës për tekstin shkollor ...

Shtojcë 1: Bibliografia

Shtojcë 2: Lista e hartues/eve të standardeve

# Hyrje

## 1. Pikënisja, sfondi

Në dokumentin «Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007 – 2017» (Prishtinë 2007), përgatitja e teksteve shkollore dhe e materialeve didaktike cilësore llogaritet ndër masat prioritare, të cilat do të sigurojnë një sistem arsimor funksional në nivelin evropian (kr. sidomos masën 4.2.3 (f. 73): «Hartimi dhe sigurimi i teksteve cilësore dhe mjeteve të tjera mësimore», gjegjësisht prioritetet për periudhën 2007-12 për këtë masë: «Përcaktimi i standardeve për tekste mësimore dhe i procedurave të miratimit; Përcaktimi i standardeve për mjete mësimore»). Arsyeya e statusit prioritar të kësaj mase gjendet në faktin që një pjesë e konsiderueshme e teksteve shkollore të përdorura aktualisht janë të vjetruara dhe nuk përputhen më me të dhënat, gjendjen dhe nevojat e Republikës së re, demokratike, të Kosovës.

Për ta zbatuar masën e përmendur dhe përmirësuar cilësinë e teksteve shkollore e të mjeteve didaktike, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) e Kosovës nisi një projekt bashkëpunimi me Shkollën e Lartë të Cyrihut/Zvicër (PHZH), përkatësisht me institutin IPE (International Projects in Education) të PHZH-së. Tema dhe qëllimi i projektit në fjalë është hartimi dhe përcaktimi i standardeve për vlerësimin e teksteve shkollore (a: për vlerësimin e teksteve shkollore ekzistuese, b: për vlerësimin e atyre që do të krijohen dhe duhen miratuar në vitet e ardhshme).

Dokumenti i pranishëm i prezanton rezultatet e projektit në fjalë, duke plotësuar, njëkohësisht, masën 4.2.3 të strategjisë së përmendur 2007-2017. Udhëheqës të projektit kanë qenë Arif Demolli, mr.sc. Hajrije Devetaku dhe Nuhi Gashi, nga ana e MASHT-it, dhe prof. dr. dr. Basil Schader, nga ana e IPE/PHZH-së. Nga Kosova dhe nga Zvicra kanë bashkëpunuar si ekspertë/e për lëndë, grupe lëndësh dhe aspekte të ndryshme metodologjike dhe si autorë/e të standardeve lëndore rreth 50 persona nga fusha e arsimit (shih listën përkatëse në shtojcë). Financimin e projektit e morën përsipër Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës, fondacioni «Lotteriefonds des Kantons Zürich», si dhe fondacioni «Hamasil» në Cyrih.

## 2. Përshkrim i shkurtër i standardeve dhe i treguesve dhe procedura e miratimit

Standardet e përmbledhura në këtë dokument përshkruajnë dhe caktojnë kritere dhe aspekte të cilat duhet t'i plotësojnë tekstet shkollore dhe mjetet didaktike aktuale, moderne në pikëpamje pedagogjike dhe didaktike.

Dokumenti fillon me një grup prej 15 standardeve të përgjithshme, të ndara në katër fusha 1) Aspekte formale, paraqitja dhe pamja, 2) Aspekte metodike dhe didaktike, 3) Aspekte pedagogjike, 4) Aspekte në lidhje me praktikën. Standardet e përmbledhura në këtë pjesë vlejné – edhe pse jo secili me të njëjtën peshë – për të gjitha tekstet shkollore. Kjo i takon p.sh. lidhjes me kurrikulin, përpunimit didaktik, apo lidhjes me realitetin shoqëror, historik dhe politik të Kosovës. Grupi i dytë i standardeve (standardet 16.1 – 16.14) lidhet me standardet specifike për secilën lëndë, të cilat duhen plotësuar p.sh. nga abetaret, tekstet shkollore të shkencave të natyrës apo nga librat e leximit, materialet didaktike parashkollore etj.

Te secili standard gjendet një listë, më shumë ose më pak e gjerë, me tregues (gjithsej 72 për 15 standardet e përgjithshme, plus treguesit specifikë, sipas lëndës dhe tipit të tekstit shkollor, të standardit 16). Treguesit fokusojné aspekte të pjesshme, të veçanta, plotësimi i të cilave është me rëndësi për standardin në fjalë (apo, në rastin e standardit 16: për tipin e veçantë të tekstit shkollor përkatës). Pranë secilit tregues ka një shkallë ku mund të vihen kryqe për vlerat 0 deri 4, të cilat kanë kuptimin vijues:

- 0 = i paplotësuar fare; d.m.th. kërkesat e formulara në treguesin përkatës nuk janë përfillur fare.
- 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm/në masë të pamjaftueshme, d.m.th. edhe pse diçka nga kërkesat e formulara në treguesin përkatës mund të jetë e përfillur, nuk mund të konsiderohet që teksti shkollor i plotëson në mënyrë të duhur kërkesat dhe kriteret përkatëse.
- 2 = i plotësuar pjesërisht; d.m.th. vetëm disa prej kërkesave të formulara në treguesin përkatës janë përfillur (më shumë sesa te vlera 1, por ende jo mjaft).
- 3 = i plotësuar mjaftueshëm, d.m.th. kërkesat e formulara në tregues janë përfillur në masa mjaft të mëdha, edhe pse disa përmirësime do të ishin të mundshme.
- 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm, d.m.th. kërkesat e formulara në treguesin përkatës janë përfillur në mënyrë shembullore.

Gjithashtu, për secilin standard mund të llogaritet, përmes një formule të thjeshtë, një vlerë e përgjithshme (shuma e vlerave të veçanta, e pjesëtuar për numrin e treguesve). Vështrimi përmbledhës i vlerave të 16 standardeve (përmes formularit në fund të dokumentit të prani-shëm) jep një pamje të plotë, të hollësishme e të diferencuar të tekstit shkollor a të materialit didaktik në fjalë; njëkohësisht ai jep të dhëna rreth aftësisimit të tekstit në fjalë dhe sugjerime për pikënisjet e përpunimit të tij.

### **Miratimi**

Bazë për miratimin e tekstit shkollor të vlerësuar duhet të jetë vlera minimale 3 (i plotësuar mjaftueshëm) për secilin standard dhe vlera 2 (i plotësuar pjesërisht) për çdo tregues. Edhe në qoftë se vlera mesatare e përgjithshme është mbi 3, recensenti duhet të kërkojë me shkrim që treguesit e vlerësuar me vlerën 0 ose 1 të përpunohen në mënyrë që teksti shkollor të fitojë lejen e botimit.

Nëse në tekstin shkollor të një fushe të caktuar një standard nuk është i rëndësishëm, gjatë vlerësimit mund të mos merret fare në konsiderim (p.sh. në një tekst të shkollave profesionale për bukëpjekës treguesi 9.4 që kërkon që aspektet historike në tekstin shkollor të trajtohen në mënyrë të peshuar dhe pa emocione nuk ka kuptim dhe mund të hiqet fare).

### **3. Sqarime terminologjike:**

- Termi «teksti shkollor» përdoret për tërësinë e librave shkollorë, materialeve shtesë apo plotësuese në lidhje me ta, doracakët përkatës etj. Mund të zëvendësohet edhe me termin «libër shkollor» kur përdoret pranë fjalës «tekst» (në kuptimin pjesë e shkëputur e një shkrimi).
- Termi «standard» (më saktë: standard i cilësisë) cakton një aspekt të një norme apo të një niveli të cilësisë, të cilin një tekst shkollor aktual dhe modern duhet ta përfillë, ta respektojë dhe ta plotësojë sipas kërkesave aktuale, të pranuar gjerësisht nga ana e pedagogjisë, didaktikës dhe shkencave të veçanta. (Shembull: Sipas kërkesave dhe normave të sotme, një tekst shkollor duhet të ketë një koncept didaktik të peshuar dhe të qartë (krahaso standardin nr. 6); gjithashtu ai duhet ta respektojë barazinë e gjinive (krahaso standardin nr. 11), etj.). Sfondi dhe synimi i secilit standard të përgjithshëm është përshkruar në një rubrikë të veçantë të standardi përkatës. (Për çështje tipologjike rreth standardeve shih edhe kreun 6.)
- Termi «tregues» shënon aspekte të pjesshme, konkrete dhe (me sa është e mundshme) të operacionalizuara, përmes të cilave mund të caktohet e të matet deri ku apo në cilat përmasa është plotësuar një standard. Shembuj: Plotësimi i standardit nr. 6 në lidhje me

konceptin didaktik matet përmes 13 treguesve konkretë, ndër të cilët p.sh. treguesi 6.3: «Lënda mësimore është ndarë në njësi dhe hapa pune të (...) qartë (...)»; kurse plotësimi i standardit nr. 11 (barazia gjinore) mund të matet p.sh. me treguesin 11.1 «Gjuha e tekstit shkollor është adekuate për të dy gjinitë, duke u drejtuar të dyjave (përdorim i trajtave mashkullore dhe femërore p.sh. Në udhëzime, detyra etj.)»

- Lidhur me nivelin parashkollor, vazhdimisht ku përdoret termi “klasa” nënkuptohet edhe “grupmosha”. Më tej:
  - “lënda mësimore” = “fushë aktiviteti”
  - “nxënës/e” = “fëmijë parashkollor”
  - “klasa heterogjene” = “grupe të përziera”
  - “shkolla” = “kopshte”
  - “mësimdhënës/e” = “edukator/e”

#### 4. Qëllimet dhe funksionet e standardeve

Ky dokument i drejtohet një publiku të ekspertëve nga fusha e arsimit dhe e administratës, përfaqësuesve të shtëpive botuese të teksteve shkollore dhe autorëve të teksteve shkollore. Qëllimi i dokumentit është fort pragmatik: Standardet e përmbledhura në të duan t'u shërbejnë specialistëve të përmendur si instrument dhe mjet ndihmës, që lejon dhe lehtëson një vlerësim (në rastin e teksteve shkollore që kanë për t'u bërë: një planifikim) të njësishtëm, të bazuar mbi kritere dhe standarde të përcaktuara e të pranuar. Kjo u takon në radhë të parë tri konteksteve dhe funksioneve vijuese:

- a) Vlerësimi i teksteve shkollore ekzistuese: Në këtë kontekst, standardet veprojnë a) si instrument dhe kuadër i përbashkët, të cilit i referohen ekspertët që merren me vlerësimin, b) si instrument për t'i përcaktuar nevojat dhe kërkesat e zhvillimit të mëtejshëm (p.sh. caktimi i pikave kryesore të përpunimit/përmirësimit të tekstit shkollor në fjalë).
- b) Përpunimi i teksteve shkollore ekzistuese apo krijimi nga e para të teksteve shkollore të reja: Në këtë kontekst, standardet u shërbejnë autorëve dhe shtëpive botuese si udhëzim (cilat pika duhen përfillur, cilat kritere duhen plotësuar etj.)
- c) Vlerësimi/miratimi i teksteve shkollore të reja a të përpunuara: Në këtë kontekst, standardet shërbejnë si instrument a kuadër i përbashkët, të cilit i referohen instancat a personat që merren me vlerësimin/miratimin.

#### 5. Udhëzime për punën konkrete me standardet

Standardet janë konceptuar për specialistë (shih më lart), të cilët duhet të kenë përvojë në fushën e teksteve shkollore dhe të mjeteve mësimore. Vlerësimi i secilit tekst shkollor duhet bërë nga të paktën tre ekspertë të pavarur, të cilët mund të kenë fokuse të ndryshme (shembuj për fokuse: korrektësi shkencore; aspekte gjuhësore; aspekte didaktike dhe të psikologjisë së të mësuarit).

Edhe nëse ekspertët e ndajnë punën e vlerësimit sipas specializimeve të tyre, do të ishte e dëshirueshme që për secilin standard të bëheshin vlerësime dhe sugjerime nga të paktën dy ekspertë. Koha e kaluar për vlerësimin e një teksti shkollor të caktuar varet nga faktorët e ndryshëm, në radhë të parë nga vëllimi dhe natyra e tekstit shkollor, nga numri i dorëshkrimeve të paraqitura për vlerësim etj., prandaj MSHT-i e vlerëson dhe e cakton vetë për sa kohë mund të kryhet vlerësimi.

Puna konkrete me këtë dokument, duke vlerësuar tekste shkollore ekzistuese apo të reja, ndahet në fazat dhe hapat vijues:



- a) Ekspertët e studiojnë me vëmendje dhe hollësisht tekstin shkollor, i cili duhet vlerësuar (përfshirë edhe komentarin/doracakun për mësues/e si dhe materialet shtesë eventuale), duke u njohur mirë me konceptin, ndërtimin/strukturën dhe përmbajtjen e tij.
- b) Ekspertët (veç e veç) e bëjnë vlerësimin e tekstit shkollor sipas 15 standardeve të përgjithshme dhe standardit nr. 16, i cili lidhet me tipin dhe lëndën e veçantë të tekstit shkollor në fjalë. Vlerësimet e tyre ata i shënojnë duke vënë kryqë në shkallët e treguesit e ndryshëm. Duhet pasur parasysh që jo secili standard për secilin tekst shkollor ka të njëjtën rëndësi.
- c) Njëkohësisht, ekspertët plotësojnë për secilin standard një fletë me rubrikat «vërejtje» dhe «sugjerime/pikënisje për përmirësim». Së bashku me vlerat e shënuara në shkallët, ato shënime, në fazën vijuese, shërbejnë si bazë për diskutim.
- d) Ekspertët i shkëmbejnë, i krahasojnë dhe i diskutojnë përfundimet e tyre (vlerat, pikënisjet për përmirësimet etj.). Ata arrijnë në konsensus për sa i përket vlerësimit për secilin tregues dhe për sa u takon pikënisjeve kryesore të përmirësimit a të përpunimit.
- e) Për secilin standard llogaritet vlera e përgjithshme (sipas formulës: shuma e vlerave të treguesve të veçantë, e pjesëtuar për numrin e treguesve).
- f) Vijon plotësimi i formularit përmbledhës («Vështrim i përgjithshëm, përmbledhës për tekstin shkollor ...», shih në fund të dokumentit) si dhe i rubrikave të atjeshme për komente me fjalë. (Ky formular jep një lloj profili të tekstit shkollor të vlerësuar. Vetëkuptohet që mund të përfytyrohen edhe mënyra grafike të tjera të krijimit të një profili të tillë; gjithashtu mund të parashikohen zgjidhje elektronike (qoftë edhe në internet) të plotësimit të formularit, të cilat e bëjnë të mundshëm një krahasim më të shpejtë të vlerësimeve).
- g) Rezultatet dhe përfundimet e vlerësimit i komunikohen instancës që ka dhënë urdhrin për vlerësim.

## 6. Objektiviteti

Përfundime dhe rezultate «objektive», të kuantifikueshme e të operacionalizueshme, mund të arrihen vetëm në lidhje me një numër treguesish tepër të kufizuar (ndër përjashtimet e rralla llogariten p.sh. standardet 11.1 dhe 11.2 që kanë të bëjnë me përdorimin gjuhësor jodiskriminues, për sa u përket gjinive, prania e barabartë e vajzave dhe e djemve në ilustrimet). Në shumicën e rasteve të tjera nuk mund t'i iket një komponente subjektive për arsye se karakteristika si «përshtatshmëria [me moshën e nxënësve/eve]», «cilësia estetike [e ilustrimeve]» etj., për të cilat nuk ka përcaktime të standardizuara, do të interpretohen nga secili ekspert në mënyrë individuale. Qëllimit të një maksimumi të objektivitetit i shërbejnë, në punën me standardet e përmbledhura në këtë dokument, masat vijuese:

- Zbatimi i vlerësimit nga ekspertë të pavarur, të kualifikuar në lëndën përkatëse, me përvojë në fushën e teksteve shkollore e të didaktikës.
- Zbatimi i vlerësimit gjithnjë nga të paktën tre (ose më shumë) ekspertë, të cilët i krahasojnë dhe i diskutojnë përfundimet e tyre.
- Spektër i gjerë me 80 – 100 aspekte të pjesëshme (tregues; numri varet nga përmasat e standardit 16). Nga kjo gjerësi rezulton një pamje e diferencuar, e hollësishme, e tekstit shkollor të vlerësuar, njëkohësisht i shmangët rrezikut të vlerësimeve globale, tepër të përgjithshme dhe sipërfaqësore.
- Disa kryqëzime a përkime të pjesëshme përmes treguesve, të cilat janë ruajtur qëllimisht, duke qenë se përkimet e lehta në fjalë kontribuojnë që aspekte dhe kritere të caktuara të fokusohen dhe të vlerësohen nga pikëpamjet e ndryshme të sistematikës së vlerësimit.

## **7. Sfonde dhe burime të përmbledhjes së standardeve, renditja tipologjike**

Këto standarde janë krijuar duke marrë parasysh kontekstin pragmatik të përdorimit të tyre si instrument për vlerësimin e teksteve shkollore ekzistuese a të reja dhe si udhëzim për përpunimin a krijimin nga e para të teksteve shkollore (shih më lart). Dokumente të ngjashme, d.m.th. lista po aq të gjera me standarde, që do të mund të shërbenin si pikë referimi, janë më shumë të rralla (kr. p.sh. listat me kritere nga Shqipëria, standardet e Kroacisë dhe të Maqedonisë, apo kriteret sllovaqe të përshkruara nga Nogova/Huttova (2006), si dhe kontributet nga disa vende të tjera në vëllimin përmbledhës të Bruillard-it (Bruillard 2006)). Hulumtime dhe pyetje te ministritë e arsimit të vendeve të ndryshme të Ballkanit, të ish-Bllokut të Lindjes dhe të SHBA-ve ishin me sukses jo mjaft të gjerë, kurse nga hulumtimet e disa institucioneve (institucione shkollore, shtëpi botuese) në Evropën Perëndimore dhe sidomos në Zvicër si dhe nga literatura përkatëse e lëmit kanë dalë disa katalogë dhe lista interesante me kritere dhe me standarde – pjesërisht të kufizuara në një lëndë të veçantë – për tekste shkollore (në të shumtën e rasteve fjala është për dokumente të brendshme, kr. p.sh. ilz (2008), Regionalsekretariat BKZ (2007) apo Nodari (1997), për të tjerat shih bibliografinë). Përveç konsultimit të literaturës përkatëse u përdoren si burime të vlefshme sidomos specializimi dhe përvoja e gjatë e drejtuesve të projektit si autorë, ekspertë dhe recensentë në fushën e teksteve shkollore në Kosovë dhe në Zvicër, si dhe njohuritë e specialistëve nga të dy vendet lidhur me aspekte dhe lëndë të veçanta.

Duke shfrytëzuar burimet e përmendura dhe duke marrë parasysh kontekstin pragmatik të përdorimit, në këtë dokument janë përmbledhur ato standarde, të cilat janë me rëndësi të veçantë edhe nga pikëpamja e përgjithshme, të pavarur nga lënda dhe tipi i tekstit shkollor, edhe nga pikëpamja specifike për lëndën dhe tipin e tekstit shkollor në fjalë.

Nga ana tipologjike, katalogu ynë, i ndarë në pesë fusha të mëdha, del jashtë sistematikës së zakonshme, e cila dallon a) standarde përmbajtësore (content apo curriculum standards), b) standarde të arritshmërisë (performance standards) dhe c) standarde për kushtet e të mësuarit (opportunity-to-learn-standards). Për sa u përket përmbajtjeve, vetëkuptohet që nga standardet tona të preken aspekte të veçanta, të rëndësishme të përmbajtjes, mirëpo jo duke përshkruar – në formë të standardeve përmbajtësore – gjithë spektrin e përmbajtjeve që duhen trajtuar. Njëfarë ngjashmërie me standardet e arritshmërisë mund të duken të kenë shkallët tona për standardet dhe treguesit, të cilët, prapësëprapë, nuk i caktojnë arritjet e nxënësve/eve, mirëpo tregojnë deri në ç'masë teksti shkollor në fjalë i plotëson standardet dhe treguesit e veçantë. Vlerësimi, kështu, i përket arritjes së tekstit shkollor lidhur me standardet dhe substandardet e caktuara. Me kategorinë e standardeve për kushtet e të mësuarit, më në fund, standardet e përmbledhura në dokumentin tonë lidhen padyshim ngushtë (duke qenë se tekstet shkollore janë një përcaktues kryesor për ato kushte), edhe pse ato nuk e realizojnë dot këtë lidhje duke marrë parasysh fushën e përgjithshme të kushteve të të mësuarit, mirëpo vetëm për sa i përket tekstit shkollor të veçantë që është objekt i vlerësimit.

## A) Standarde të përgjithshme

### I) Aspekte formale; paraqitja dhe pamja etj. (standardet 1 – 3)

#### Standardi 1: Përputhshmëria me kurrikulin dhe me tekstet shkollore të së njëjtës lëndë të klasave pararendëse dhe pasuese (1.1-1.3)

**Synim:** Teksti shkollor të përputhet me parimet dhe me qëllimet e përgjithshme të edukimit e të kurrikulit të Republikës së Kosovës, si dhe me kurrikulin e lëndës dhe të klasës (apo të ciklit) në fjalë. Teksti shkollor të përputhet, për sa i përket konceptit dhe mënyrës së të mësuarit e të punuarit, me tekstet shkollore të së njëjtës lëndë të klasave pararendëse dhe pasuese, duke garantuar kështu vazhdimësinë dhe koherencën e programit të mësimit në këtë lëndë.

**Tregues:** (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
1.1	Teksti shkollor përputhet ngushtë me parimet dhe qëllimet e përgjithshme të kurrikulit shkollor të Kosovës.					
1.2	Teksti shkollor përputhet ngushtë me kurrikulin e lëndës dhe të klasës (apo të nivelit) për të cilën ai është konceptuar.					
1.3	Teksti shkollor përshtatet mirë me konceptin dhe me renditjen e teksteve shkollore të së njëjtës lëndë; ai përputhet (edhe për sa u përket termave teknikë) me konceptin dhe mënyrën e të mësuarit dhe të të punuarit të teksteve shkollore të së njëjtës lëndë të klasave pararendëse dhe pasuese dhe e ruan vazhdimësinë e programit mësimor të lëndës në fjalë (parimi i të mësuarit në formë të spirales: trajtimi dhe thellimi i aspekteve të caktuara mbi nivele gjithnjë më komplekse gjatë kurrikulit).					

**Vlera e përgjithshme për standardin 1 ({1.1 – 1.3} : 3) =** \_\_\_\_\_

## Standardi 2: Paraqitja, pamja, qartësia

**Synim:** Teksti shkollor të ketë një faqosje të pëlqyeshme dhe një strukturë (ndërtim) të qartë, e cila mundëson orientimin. Mënyra e shtypjes e të lidhjes së tekstit shkollor të jetë me cilësi të mirë, kështu që ai të mund të përdoret disa herë.

**Tregues:** (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
2.1	Paraqitja dhe pamja e jashtme dhe e brendshme të tekstit shkollor janë të pëlqyeshme dhe aktuale (u takon aspekteve si pamja e kopertinës, faqosja, koherenca e konceptit grafik dhe të faqosjes, madhësia e shkronjave, largësia midis rreshtave).					
2.2	Teksti shkollor si tërësi ka një strukturë të qartë e të kapshme, e cila bën të mundur një orientim të shpejtë dhe të lehtë (p.sh. përmes një pasqyre të lëndës, përmes regjistrave etj.; gjithmonë duke marrë parasysh moshën e nxënësve/eve).					
2.3	Teksti shkollor e mundëson orientimin në secilën faqe në mënyrë të përshtatshme për moshën e nxënësve/eve: faqet nuk janë të mbingarkuara; elementet dhe mjetet grafike (përfshirë simbole dhe piktograme që ndihmojnë në orientimin) si dhe ilustrimet përdoren në mënyrë të qëlluar.					
2.4	Burimet e teksteve të marra nga veprat e tjera janë dhënë me korrektësi.					
2.5	Fortësia e lidhjes, cilësia e letrës së përdorur dhe e kopertinës (eventualisht e plastifikuar), si dhe ajo e shtypit janë të tilla që teksti shkollor mund të përdoret disa vjet. (Ky tregues nuk vlen për fletore pune dhe materiale të tjera për përdorimin e njëhershëm).					

**Vlera e përgjithshme për standardin 2 ({2.1 – 2.5} : 5) =** \_\_\_\_\_

### Standardi 3: Ilustrimet

**Synim:** Ilustrimet (fotografi, vizatime, piktura, diagrame, tabela, grafikë, ndoshta edhe komente të shkurtra shpjeguese) të kenë lidhje prodhimtare (krijuese), plotësuese<sup>1)</sup> me shkrimet në tekstin shkollor. Cilësia e ilustrimeve të jetë e lartë nga pikëpamja estetike, dokumentare apo shpjeguese.<sup>2)</sup>

**Shpjegime:** <sup>1)</sup> Raport prodhimtar, plotësues midis ilustrimeve dhe teksteve; shembuj: Pikturat a fotografitë në libra leximi nuk duhet ta tregojnë dhe ta riprodhojnë thjesht atë që gjendet që në tekst, por duhet të përmbajnë informata plotësuese për tekstin, duke i nxitur kështu nxënësit/et që të merren në mënyrë të thelluar me tekstin. Në tekstet shkollore të matematikës e të shkencave të natyrës, diagrame, tabela dhe grafikë duhet ta plotësojnë, ta vizualizojnë a ta përmbledhin në mënyrë të kapshme atë që gjendet në tekst. Në tekstet shkollore të historisë a të shkencave të natyrës, fotografitë dokumentare etj. duhet t'i plotësojnë tekstet duke u shtuar atyre dokumente vizuale autentike, të cilat e nxitin procesin e të kuptuarit.

<sup>2)</sup> Cilësia e lartë; shembuj: Ilustrime të një niveli të lartë estetik në libra leximi; fotografi të kapshme, me vlerë dokumentare a shpjeguese në tekste shkollore të historisë e të shkencave të natyrës; diagrame të qarta, të cilat e nxitin procesin e të kuptuarit në tekste shkollore të matematikës e të shkencave të natyrës.

**Tregues:** (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
3.1	Ilustrimet (fotografi, vizatime, piktura, diagrame, tabela, grafikë etj.) gjenden në një raport krijues, plotësues (shih shpjegimin 1) me tekstet.					
3.2	Ilustrimet tregojnë një cilësi të lartë nga pikëpamja estetike, dokumentare apo shpjeguese (shih shpjegimin 2).					
3.3	Ilustrimet janë të llojshme dhe përputhen me përmbajtjen e njësive mësimore.					
3.4	Ilustrimet janë të mjaftueshme për njësitë mësimore.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 3 ({3.1 – 3.4} : 4) = \_\_\_\_\_**

## II) Aspekte metodike dhe didaktike (Standardet 4 – 8)

### Standardi 4: Cilësia, relevanca (thelbësorja) dhe aktualiteti në pikëpamje përmbajtësore dhe shkencore

**Synim:** Nga ana e përmbajtjes, si dhe për sa u përket aspekteve shkencore dhe didaktike të lëndës në fjalë, tekstet (përk. kombinimet tekst – ilustrim) dhe ushtrimet e përmbledhura në tekstin shkollor të tregojnë një nivel të lartë, bashkëkohor, të jenë relevante për (nën-)temat e trajtuara dhe aktuale për sa i takon trajtimin metodik. Me këtë, teksti shkollor të kontribuojë në ndërtimin sistematik të kompetencës lëndore të nxënësve/eve, përkatësisht të njohurive të tyre në lëndën përkatëse.

**Tregues:** (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
4.1	Shkrimet në tekstin shkollor kanë përmbajtje me cilësi të lartë, ato kanë një vlerë të lartë arsimore dhe edukative dhe janë në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme e të së nesërme.					
4.2	Nga pikëpamja shkencore, shkrimet, fushat dhe aspektet e zgjedhura në tekstin shkollor janë korrekte, relevante (thelbësore) dhe me vlerë shembullore për temën a për nëntemat e trajtuara.					
4.3	Shkrimet, aspektet, mënyrat metodike të trajtimit si dhe tipat e ushtrimeve, detyrave dhe pyetjeve të zgjedhura në tekstin shkollor janë në përputhje me nivelin aktual të shkencës përkatëse dhe të didaktikës së lëndës në fjalë.					
4.4	Duke qenë a) i mbështetur shkencërisht dhe b) aktual nga pikëpamja metodike e didaktike, teksti kontribuon në ndërtimin sistematik të njohurive dhe të kompetencave të nxënësve/eve në lëndën përkatëse (kr. edhe standardin 16).					

**Vlera e përgjithshme për standardin 4 ({4.1 – 4.4} : 4) =** \_\_\_\_\_

## Standardi 5: Përshtatshmëria me moshën e nxënësve/eve

**Synim:** Për sa i përket përmbajtjes, pamjes, vështirësisë, faqosjes etj., teksti shkollor të përshtatet me moshën e nxënësve/eve, për të cilët ai është konceptuar. Teksti shkollor të jetë i kapshëm, i vlefshëm nga ana arsimore dhe edukative, dhe tërheqës për grup-moshën në fjalë. (Për aspektet gjuhësore shih standardin 8).

**Tregues:** (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
5.1	Temat e trajtuara në tekstin shkollor përputhen mirë me mundësitë njohëse dhe intelektuale të grup-moshës në fjalë (për diferencimin e brendshëm shih standardin 6.7).					
5.2	Shkrimet (përkatesisht kombinimet tekst-ilustrim) e përmbledhura në tekstin shkollor janë në përputhje me përvojat, kërkesat, rrethanat e jetës (shkurt: me «botën») së grup-moshës përkatëse. Duke marrë parasysh gjerësinë dhe heterogjenitetin e atyre përvojave, rrethanave etj., teksti shkollor përpiket që t'u referohet në tërësi konteksteve sa më të ndryshme, duke u bërë me këtë paletë të gjerë i kapshëm dhe tërheqës për pjesën dërmuese të nxënësve/eve.					
5.3	Elementet grafike të tekstit shkollor (fotografitë, grafikët etj.) janë në përputhje me grup-moshën në fjalë dhe janë të kapshme dhe tërheqëse për atë.					
5.4	Pamja dhe paraqitja e jashtme dhe e brendshme (formati, faqosja, madhësia e shkronjave, largësia midis rreshtave etj.) i përshtaten grup-moshës në fjalë.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 5 ({5.1 – 5.4} : 4) =** \_\_\_\_\_

## Standardi 6: Përpunimi dhe përpilimi didaktik

**Synim:** Teksti shkollor të ketë një koncept didaktik të peshuar e të menduar mirë. Përgatitja, përpilimi dhe përpunimi i njësive mësimore, udhëzimeve dhe ushtrimeve të përmbledhura në të, të mbështet në postulatet aktuale didaktike: si të mësuarit në mënyrë të pavarur, kooperative dhe të thelluar (transferuese). Teksti shkollor të ofrojë materiale, sugjerime dhe detyra të cilat janë të përshtatshme për nivele intelektuale të ndryshme dhe për tipat dhe mënyrat e ndryshme të të mësuarit (kognitive/vizuale/vepruese etj.).

**Shënim:** Ndërtimi i kapshëm i tekstit shkollor dhe informatat e qarta për qëllimet dhe kërkesat (shih sidomos 6.3 dhe 6.4, kr. edhe 2.3) kanë edhe efektin pozitiv që prindërit të kuptojnë më mirë çka ndodh dhe çka kërkohet në mësim, në mënyrë që edhe ata të jenë në gjendje t'i ndihmojnë më lehtë fëmijët e tyre p.sh. në detyrat e shtëpisë.

**Tregues:** (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
6.1	Teksti shkollor ngrihet mbi një koncept të qartë, të menduar, koherent dhe sa më të larmishëm e të shumëllojshëm, të cilin ai e ndjek në mënyrë konsekuente.					
6.2	Temat, shkrimet, detyrat dhe ushtrimet në tekstin shkollor janë renditur sipas një progresioni të qartë: prej së thjeshtës drejt më të komplikuarës dhe prej së lehtës drejt më të vështirës.					
6.3	Përmbajtja e tekstit shkollor është ndarë në njësi dhe hapa pune të përshtatshëm, të qartë e të kuptueshëm për nxënësit/et.					
6.4	Teksti shkollor nxënësve/eve ua shpjegon dhe ua bën të qartë qëllimet, kërkesat dhe rrugët/mënyrat e të mësuarit, duke i ndihmuar kështu që të orientohen në mënyrë të pavarur, që të kenë parasysh qëllime të qarta dhe që të mësohen me vetëvlerësimin e të mësuarit të vet.					
6.5	Parimet e qartësisë (konkretësisë) e të kuptueshmërisë janë plotësuar në mënyrë optimale, kjo p.sh. përmes ilustrimeve, grafikëve, shpjegimeve të fjalëve të pazakonshme si dhe përmes formulimeve sa më të qarta e të kapshme të detyrave për ushtrime, thellime etj.					
6.6	Teksti shkollor përmban detyra, ushtrime dhe sugjerime të shumëllojshme, me variacione, të cilat i nxitin dhe i motivojnë nxënësit/et që të merren në mënyrë të thelluar me lëndën e trajtuar, duke përkrahur kështu procesin e përvetësimit dhe të transferimit të njohurive. (Ky tregues nuk vlen për tekste shkollore për të cilët ekzistojnë fletore pune të veçanta). Krahaso edhe standardin 14.					
6.7	Për secilën (nën-)temë apo aspekt, teksti shkollor përmban shkrime, materiale, ushtrime dhe detyra në nivele të					



	ndryshme për sa u përket kërkesave dhe vështirësisë. Me këtë veçori teksti shkollor është i përshtatshëm edhe për diferencimin e brendshëm në klasat heterogjene si dhe për përdorimin në shkolla dhe klasa nga kontekstet sociodemografike me nivele arsimore të ndryshme.					
6.8	Përmes materialeve dhe udhëzimeve të përshtatshme, teksti shkollor e nxit, kudo ku është e mundur dhe me kuptim, të mësuarit në mënyrë të pavarur.					
6.9	Teksti shkollor e nxit zhvillimin e aftësive metakognitive, të lidhura me procesin e të mësuarit, të nxënësve/eve (njohuri dhe dijeni procedurale, d.m.th. të tematizohet çështja si mund të mësohet në mënyrë sa më efektive, t'u tregohen nxënësve/eve rrugë, strategji dhe teknika përkatëse).					
6.10	Materialet dhe detyrat e përmbledhura në tekstin shkollor (tema, shkrime, ushtrime etj.) janë të përshtatshme për përpunim në forma të ndryshme sociale të mësimit (p.sh. mësim në klasë/frontal, punë në çifte, punë në grupe).					
6.11	Teksti shkollor përmban materiale, udhëzime, detyra etj., të cilat janë të përshtatshme dhe motivuese për të mësuarit në mënyrë kooperative, komunikative dhe ndërvepruese.					
6.12	Teksti shkollor përmban materiale, sugjerime, detyra etj., të cilat lejojnë hyrje të ndryshme në temën e trajtuar dhe të cilat janë të përshtatshme për tipa të ndryshëm të nxënësve/eve (p.sh. për nxënës/e që mësojnë më shumë në mënyrë vizuale, përkatësisht kognitive apo vepruese).					
6.13	Koncepti didaktik dhe sugjerimet didaktike të tekstit shkollor janë të realizueshme duke marrë parasysh kushtet materiale dhe infrastrukturale të shkollave të Kosovës.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 6 ({6.1 – 6.13} : 13) =** \_\_\_\_\_

## Standardi 7: Pyetjet dhe detyrat

**Synim:** Pyetjet dhe detyrat e paraqitura në tekstet shkollore, përveç njohurive, të stimulojnë edhe të mësuarit e shkathtësive, qëndrimeve dhe të vlerave. Të jenë të hapura, të kenë qasje kreative, në mënyrë që nxënësit/et të jenë aktivë në procesin mësimor dhe të mund të arrijnë në konkluzione të pavarura.

**Tregues:** (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
7.1	Për sa i përket anës përmbajtësore, pyetjet janë të hartuara në nivele të ndryshme të njohjes (kr. standardin 6.7).					
7.2	Për sa i përket qasjes metodologjike, pyetjet e hartuara ndihmojnë zhvillimin e kreativitetit të nxënësve/eve.					
7.3	Formulimi i pyetjeve dhe detyrave u ndihmon nxënësve/eve që të krijojnë shprehinë e të menduarit të nivelit të lartë.					
7.4	Paraqitja e detyrave në tekstet shkollore stimulon nxënësit/et që të bëhen hulumtues të pavarur dhe të gjejnë burime të ndryshme të informacioneve.					
7.5	Detyrat e përzgjedhura në tekstin shkollos e favorizojnë punën grupore të nxënësve/eve dhe zhvillojnë aftësitë dhe shkathtësitë në zgjidhjen e situatave problemore.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 7 ({7.1 – 7.5 } : 5) =** \_\_\_\_\_

## Standardi 8: Aspekte gjuhësore

**Synim:** Gjuha e tekstit shkollor të jetë pa gabime, në përputhje me normat e gjuhës standarde dhe të mund t'u shërbejë nxënësve/eve si shembull. Për sa u përket aspekteve leksikore dhe sintaksore, por edhe gjatësisë së njësive mësimore (shkrimeve për një njësi mësimore), t'u përshtatet moshës dhe aftësive gjuhësore të klasës për të cilën teksti shkollor është konceptuar. Formulimet sidomos të udhëzimeve dhe të detyrave të jenë të kapshme dhe të thjeshta, duke nxitur kështu të mësuarit në mënyrë të pavarur të nxënësve/eve. Përveç kësaj, teksti shkollor të ofrojë për të njëjtën temë shkrime dhe materiale në nivele gjuhësore të ndryshme, duke përkrahur dhe nxitur me këtë të gjithë nxënësit/et. Tekstet shkollore veçanërisht të klasave të ulëta t'i përfillin karakteristikat e situatës gjuhësore të Kosovës (p.sh. të qenët pranë e pranë të dialektit gegë e të gjuhës standarde të shqipfolësit) dhe të kontribuojnë që nxënësit/et të mësohen në mënyrë të kujdesshme, por sistematike me variantin standard.

**Tregues:** (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
8.1	Për sa i përket leksikut të përdorur, gjuha e tekstit shkollor është e kapshme dhe në përputhje me moshën për të cilën teksti është konceptuar.					
8.2	Për sa i përket kompleksitetit sintaksor, gjuha e shkrimeve në tekstin shkollor është e kapshme dhe në përputhje me moshën dhe me mundësitë gjuhësore të klasës, për të cilën teksti është konceptuar.					
8.3	Gjatësia e teksteve u përshtatet moshës dhe kompetencave të leximit të klasës përkatëse (shih edhe 8.5).					
8.4	Formulimet sidomos të detyrave, udhëzimeve etj. janë tepër të kapshme e të thjeshta, duke i ndihmuar kështu nxënësit/et që të punojnë në mënyrë të pavarur.					
8.5	Teksti shkollor përmban shkrime në nivele gjuhësore dhe me gjatësi të ndryshme, duke marrë parasysh diferencimin e brendshëm dhe me qëllim që nxënësit/et me kompetenca gjuhësore të ndryshme të gjejnë hyrje dhe materiale të përshtatshme për nivelin e tyre.					
8.6	Nga ana morfologjike, sintaksore dhe drejtshkrimore, gjuha e tekstit shkollor është pa gabime dhe në përputhje të plotë me normat e variantit standard të gjuhës.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 8 ({8.1 – 8.6} : 6) =** \_\_\_\_\_

### III) Aspekte pedagogjike (standardet 9 – 12)

#### Standardi 9: Lidhjet me realitetin shoqëror, historik dhe politik

Synim: Teksti shkollor të përputhet me parimet themelore të kushtetutës së Republikës së Kosovës. Teksti shkollor t'i shmanget çdo njëanshmërie dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, të përkrahë dhe të nxisë tolerancën, mirëkuptimin e ndërsjellë dhe kompetencën ndërkulturore.

Tregues: (0 = i paplotësuar fare; 1 = i paplotësuar pamjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
9.1	Teksti shkollor, në pikëpamje politike, etnike dhe fetare, e nxit tolerancën dhe pluralizmin, duke qenë edhe vetë i hapur, tolerant dhe pluralist					
9.2	Kudo ku teksti shkollor i referohet Kosovës dhe jetës së sotme në Kosovë, ato lidhje krijohen në sfondin eksplicit të një shteti demokratik dhe paqësor dhe të një shoqërie e cila ka si synim kushtetues bashkëjetesën e barabartë dhe paqësore të grupeve të ndryshme etnike, fetare, shoqërore e kulturore.					
9.3	Teksti shkollor nuk i referohet, në mënyrë të njëanshme, vetëm një grupi etnik të veçantë dhe përvojave të tij. Me tekstet, sugjerimet dhe detyrat e përmbledhura në të, ai pasqyron, përkundrazi, realitetin shumetnik, duke kontribuar kështu në qëllimet e kuptimit të ndërsjellë dhe të bashkëjetesës së përmirësuar, si dhe në ndërtimin e kompetencave ndërkulturore.					
9.4	Aspekte historike në tekstin shkollor trajtohen në mënyrë të peshuar, objektive dhe pa emocione.					

Vlera e përgjithshme për standardin 9 ({9.1 – 9.4} : 4) = \_\_\_\_\_

**Standardi 10: Lidhjet me aspektet Edukim për pjekuri/pavarësi, Edukim për demokraci, Edukim paqësor**

**Synim:** Teksti shkollor të nxisë zhvillimin e fëmijëve dhe të të rinjve si qytetarë të pjekur, të pavarur e të vetëvendosës. Teksti shkollor të ndihmojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në edukimin për demokraci<sup>1)</sup> dhe në edukimin paqësor, duke u orientuar drejt vlerave etike dhe pedagogjike si: tolerancë, gatishmëri për kooperim dhe për të marrë përgjegjësi, kompetencë komunikative dhe kompetencë sociale në situata konfliktuoze, kurajë qytetare, integrim, heqje dorë nga dhuna, mbrojtje e minoriteteve. Në mënyrë të drejtpërdrejtë kjo mund të ndodhë p.sh. përmes zgjedhjes së shkrimeve në libra leximi a në tekste shkollore të lëndëve etikë, edukatë qytetare apo histori. Veç kësaj, aftësia për dialog, toleranca dhe arritja e barabartë e marrëveshjeve midis interesave dhe opinionëve të ndryshme, mund të ushtrohet në mënyrë të tërthortë dhe po aq efikase në tekstet shkollore të lëndëve të ndryshme: përmes pyetjeve, sugjerimeve dhe detyrave të përshtatshme, të cilat e nxitin dialogun si dhe bashkë- dhe ndërveprimin midis nxënësve/eve, dhe përmes sugjerimit të skenarëve didaktikë përkatës.

<sup>1)</sup> *Education for democratic citizenship*; kr. programin përkatës të Këshillit Evropian.

**Tregues:** (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
10.1	Teksti shkollor e mundëson zhvillimin e pjekurisë dhe të pavarësisë së nxënësve/eve nëpërmjet zgjedhjes dhe paraqitjes së përmbajtjes (shkrime, materiale etj.) si dhe nëpërmjet pyetjeve dhe detyrave, të cilat i nxisin dhe i përkrahin nxënësit/et që të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe kritike. Në aspektin e fundit mund të kontribuojnë edhe udhëzimet për strategjitë e të mësuarit, mundësitë për vetëkorrekturë etj. (krahaso edhe standardin 6.9).					
10.2	Me zgjedhjen e shkrimeve, materialeve dhe të detyrave, teksti shkollor orientohet në mënyrë të drejtpërdrejtë (me aq sa është e mundur dhe me kuptim në lëndën përkatëse) drejt qëllimeve dhe vlerave të edukimit për demokraci dhe të edukimit paqësor.					
10.3	Teksti shkollor ndihmon edhe në mënyrë të tërthortë në qëllime të rëndësishme të edukimit për demokraci dhe të edukimit paqësor (aftësi për dialog, gatishmëri për kooperim, kompetencë sociale në situata konfliktuoze, tolerancë etj.; shih më lart), kjo p.sh. nëpërmjet pyetjeve dhe detyrave të përshtatshme, të cilat i nxitin kompetencat sociale					

	dhe ndërvepruese.					
10.4	Teksti shkollor jep një ndihmesë jo vetëm në zhvillimin e kompetencave dhe të njohurive lëndore (shih standardin 4.4), por edhe në atë të kompetencave personale dhe sociale.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 10 ({10.1 – 10.4} : 4) = \_\_\_\_\_**

## Standardi 11: Reflektimi i barazisë gjinore

**Synim:** Teksti shkollor të kontribuojë në edukimin për barazinë e gjinive dhe në shmangien e diskriminimit lidhur me gjininë, si dhe të klisheve gjinore në lidhje me ndarjen e roleve. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, kjo ndihmesë mund të jepet nga tekstet shkollore të disa lëndëve (libra leximi, tekste shkollore të etikës, historisë, të shkencave shoqërore) nëpërmjet zgjedhjes së përshtatshme të shkrimeve, pyetjeve dhe detyrave. Në mënyrë të tërthortë, të gjitha tekstet shkollore mund dhe duhet ta plotësojnë këtë standard duke u kujdesur a) që nga ana gjuhësore të respektohen të dy gjinitë (përdorimi i trajtave femërore dhe mashkullore; p.sh. nxënës/e) dhe b) që në tekstet, ilustrimet, detyrat etj. femra dhe meshkuj të jenë përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe jo të klishezuar sipas roleve tradicionale.

**Tregues:** (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
11.1	Gjuha e tekstit shkollor është adekuate për të dy gjinitë, duke u drejtuar të dyjave (përdorim i trajtave mashkullore dhe femërore p.sh. në udhëzime, detyra etj.).					
11.2	Në tekstet e njësive mësimore, ilustrimet, detyrat, pyetjet etj., meshkujt dhe femrat janë përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe po aq të shpeshtë, kur e lejon natyra e temës.					
11.3	Në tekstet e njësive mësimore dhe në detyrat, ushtrimet dhe pyetjet, teksti shkollor u referohet në mënyrë të barabartë dhe po aq të shpeshtë përvojave dhe interesave të femrave sa atyre të meshkujve.					
11.4	Teksti shkollor u shmanget klisheve gjinore në lidhje me ndarjen e roleve, si dhe pamjeve të njëanshme, duke treguar dhe duke paraqitur femra dhe meshkuj në aktivitete dhe kontekste të ndryshme e jo të klishezizuara.					
11.5	Të dy seksat portretizohen, pasqyrohen dhe kanë role në mënyrë të barabartë si në jetën private (në familje), ashtu edhe në të gjitha sferat e jetës shoqërore (në sferë publike, në kontekst historik etj.).					
11.6	Përdorimi i gjuhës është i drejtë dhe i barabartë për të dy gjinitë, sidomos kur përdoret forma femërore dhe mashkullore në emërtimin e personave.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 11 ({11.1 – 11.6} : 6) = \_\_\_\_\_**

## Standardi 12: Përmbajtja ndërkurrikulare të tjera të rëndësishme

**Synim:** Teksti shkollor të plotësojë kërkesat e fushave vijuese, që janë me rëndësi të madhe edukative: Edukim për ruajtjen e mjedisit, edukim shëndetësor, edukim për media (d.m.th. për përdorimin e përshtatshëm të mediave dhe për një sjellje të pavarur ndaj tyre), edukim parandalues kundër përdorimit të drogave. Në disa tekste shkollore (libra leximi, tekste shkollore të lëndëve etike, gjeografi, biologji, sociologji etj.) kjo ndihmesë mund dhe duhet të jepet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Por edhe tekstet shkollore të lëndëve të tjera mund të kontribuojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për këto qëllime, qoftë nëpërmjet zgjedhjes së teksteve të njësive mësimore dhe shembujve të përshtatshëm (shembull: llogaritje rreth temave mbeturina/mjedis), qoftë nëpërmjet pyetjeve, detyrave apo sugjerimeve për diskutime të përshtatshme.

**Tregues:** (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
12.1	Teksti shkollor, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kultivon ndjenjën e dashurisë ndaj mjedisit dhe formon ndërgjegjen për ruajtjen e tij.					
12.2	Teksti shkollor jep, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, një ndihmesë në edukimin shëndetësor (duke tematizuar aspekte si ushqimi, sporti/lëvizja, higjiena).					
12.3	Teksti shkollor jep, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, një ndihmesë në edukimin për përdorimin e përshtatshëm të mediave dhe për një sjellje të pavarur ndaj tyre (p.sh. duke i nxitur nxënësit/et që të bëjnë hulumtime në internet, që të krahasojnë gazeta/burime të ndryshme etj.).					
12.4	Teksti shkollor jep, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, një ndihmesë në edukimin parandalues kundër përdorimit të duhanit, të alkoolit dhe të drohës.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 12 ({12.1 – 12.4} : 4) = \_\_\_\_\_**



## IV) Aspekte të praktikës pedagogjike (standardet 13 – 15)

### Standardi 13: Doracak për mësime/et; përdorshmëria e tij

**Synim:** Pjesë e tekstit shkollor të bëhet një doracak për mësime/et, në të cilin 1) shpjegohen në mënyrë të kapshme e të qartë qëllimet, koncepti didaktik, ndërtimi dhe pikat kyçe të tekstit shkollor, si dhe mënyra e parashikuar si duhet punuar dhe planifikuar me të dhe i cili 2) përmban udhëzime dhe propozime të shkurtra, konkrete për trajtimin mësimor të secilës nëntemë, faqe, të secilit shkrim, material, ushtrim etj. Ky doracak, së bashku me konceptin e peshuar të vetë tekstit shkollor, i nxit mësime/et në punën e tyre dhe kontribuon fort në përdorshmërinë e tekstit shkollor dhe në përdorimin mësimor të tij të përshtatshëm.

**Tregues:** (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
13.1	Pjesë e tekstit shkollor është një doracak për mësime/et.					
13.2	Doracaku për mësime/en i tekstit shkollor informon në mënyrë të shkurtër e të kapshme për qëllimet, konceptin didaktik, ndërtimin, pikat kyçe dhe mënyrën si duhet punuar me tekstin shkollor.					
13.3	Doracaku jep sugjerime dhe udhëzime konkrete, të lidhura ngushtë me praktikën, për trajtimin mësimor të secilës temë, nëntemë, faqe, detyrë etj.					
13.4	Doracaku përmban udhëzime për planifikimin (po qe e mundshme: për makro- si dhe për mikroplanifikimin) e mësimit.					
13.5	Përdorshmëria e doracakut është e thjeshtë dhe e qartë, jep një ndihmesë të vlefshme në zbatimin mësimor të tekstit shkollor dhe në punën mësimore të mësime/eve.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 13 ({13.1 – 13.5} : 5) = \_\_\_\_\_**

## Standardi 14: Materiale pune (ushtrime etj.) në lidhje me tekstin shkollor

**Synim:** Teksti shkollor të përmbajë materiale pune (detyra, sugjerime, ushtrime, fletë pune etj.), të cilat e përkrahin dhe nxitin përvetësimin e thelluar dhe efektiv të lëndës së trajtuar, si dhe ushtrimin dhe përdorimin e njohurive të reja. Materialet e punës në fjalë mund të jenë të integruara (p.sh. në formë të udhëzimeve, detyrave dhe ushtrimeve në vetë tekstin shkollor) apo të veçanta (p.sh. në formë të një fletoreje pune që e shoqëron tekstin shkollor, apo të një CD-je me fletë pune etj., të cilat mësimdhënësi/ja mund t'i shtypë dhe ndoshta edhe t'i modifikojë sipas nevojave të klasës përkatëse, apo në formë të programeve mësimore elektronike). Materialet e punës, sugjerimet dhe detyrat thelluese të jenë kompatible dhe komplementare me tekstin shkollor. Ato të jenë të larmishme, të shumëllojshme dhe motivuese, gjithashtu ato të jenë të përshtatshme për nivele intelektuale të ndryshme (duke e marrë parasysh nevojën e diferencimit të brendshëm) dhe për mënyra të ndryshme për t'u marrë me lëndën (në mënyrë më shumë kognitive/vepruese/vizuale etj.); krahaso edhe standardin 6 (përpunim didaktik).

**Tregues:** (0 = i paplotësuar; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
14.1	Teksti shkollor përmban (në vetë librin apo si pjesë e veçantë) materiale pune (detyra, sugjerime, ushtrime etj.), të cilat i shërbejnë përpunimit, përvetësimin dhe ushtrimin të thelluar dhe efektiv të lëndës së trajtuar.					
14.2	Materialet shtesë janë kompatible dhe komplementare me vetë tekstin shkollor.					
14.3	Nga ana metodike, materialet e punës (ushtrimet, sugjerimet, detyrat etj.) janë të larmishme dhe të shumëllojshme. Ato janë të përshtatshme gjithashtu për diferencimin e brendshëm dhe për mënyra të ndryshme për t'u marrë me lëndën (krahaso standardet 6.7 dhe 6.12).					

**Vlera e përgjithshme për standardin 14 ({14.1 – 14.3} : 3) = \_\_\_\_\_**

## Standardi 15: Sprovimi/testimi praktik, paraprak, i tekstit shkollor

**Synim:** Para lejimit, përkatësisht miratimit zyrtar, teksti shkollor të jetë testuar dhe sprovuar gjerësisht dhe për një kohë të mjaftueshme në praktikën mësimore të klasave shkollore të ndryshme dhe në kontekste socio-demografike të ndryshme (fshat – qytet, popullsi me shkollim të mirë / të dobët). Faza e testimit të jetë ndjekur dhe të jetë vlerësuar në mënyrë të kujdesshme dhe shkencërisht serioze, rezultatet përkatëse të mund të verifikohen dhe të jenë përfillur në redaktimin e variantit përfundimtar të tekstit shkollor.

**Tregues:** (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)

Nr.	Tregues	0	1	2	3	4
15.1	Para lejimit zyrtar, teksti shkollor ishte (në rastin e librave të rinj: do të jetë) sprovuar dhe testuar në të paktën tetë klasa në kontekste socio-demografike të ndryshme (shih më lart) gjatë një periudhe të mjaftueshme (zakonisht një vit shkollor).					
15.2	Faza e testimit ishte (në rastin e librave të rinj: do të jetë) ndjekur në mënyrë serioze dhe ishte mbyllur me një vlerësim përfundimtar, rezultatet e të cilit mund të verifikohen dhe janë përfillur në redaktimin përfundimtar të tekstit shkollor.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 15 ({15.1 – 15.2} : 2) = \_\_\_\_\_**

## B) Standarde plotësuese sipas lëndëve

### 16.1 Gjuha amtare (gjuha në të cilën jepet mësimi në pjesën përkatëse të vendit)

#### 16.1.1 Standarde plotësuese për abetare

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.1.1.1	Abetarja siguron (edhe përmes udhëzimeve përkatëse në doracakun për mësuesin/en) që fëmijët të kuptojnë që në fillim të vitit shkollor natyrën (strukturën, ndërtimin), funksionet dhe mundësitë e shkrimit dhe të teknike kulturore të të shkruarit e të të lexuarit. (Mbi bazë të këtij kuptimi, procesi i mësimi të shkrimit dhe leximit përparon me një motivim të brendshëm, primar, dhe i shmanget rrezikut që të degjenerohet në një stërvitje mekanike të shkrimit të shkronjave.)					
16.1.1.2	Rendi sipas të cilit mësohen grafemat (shkronjat), përkatësisht korrelacionet midis fonemave dhe grafemave, ndjek një koncept të arsyetuar (p.sh. shpeshtësi e shkronjave në alfabet).					
16.1.1.3	Leksiku i përdorur orientohet rreptësisht drejt shpeshtësisë dhe rëndësisë së fjalëve; fjalë të rralla përdoren vetëm si përjashtim.					
16.1.1.4	Abetarja i përfill veçantitë gjuhësore të Kosovës, p.sh. të qenët pranë e pranë të dialektit gegë e të gjuhës standarde të shqipfolësit, dhe kontribuon në mënyrë të kujdesshme, por sistematike, që nxënësit/et njihen me variantin standard (kr. edhe standardin 8).					
16.1.1.5	Abetarja i ka parasysh vështirësitë e mundshme të alfabetizimit (probleme/ngatërrime rreth fonemave të ngjashme si ç, q, gj, xh në gjuhën shqipe apo rreth grafemave të ngjashme si b – d, probleme të lidhjes së shkronjave gjatë leximit etj.) dhe ka kujdes të veçantë në fushat përkatëse, duke zhvilluar kështu edhe ndërgjegjen fonologjike të nxënësve/eve.					
16.1.1.6	Për ta lehtësuar dhe për ta nxitur procesin e leximit, tekstet të paktën në dy të tretat e para të abetares jepen jo në rreshta të zakonshëm, por ndahen kështu që secili rresht përmban vetëm një njësi sintaksore apo kuptimore.					
16.1.1.7	Abetarja përdor tipa të shkronjave që lexohen lehtë dhe që janë të përshtatshme për këtë moshë, si dhe – veçanërisht në fillim – shkronjat mjaft të mëdha.					
16.1.1.8	Largësia midis rreshtave është mjaft e madhe, me					

	qëllim që faqet të jenë të qarta e të kapshme dhe për ta lehtësuar orientimin e nxënësve/eve në tekstin.					
16.1.1.9	Sidomos për fazën fillestare, abetarja ofron shumë fotografi, piktura etj., si dhe sugjerime përkatëse në komentat, me karakter motivues për biseda dhe komunikim gojor me qëllim të përkrahjes së zhvillimit gjuhësor të nxënësve/eve.					
16.1.1.10	Abetarja e nxit punën e pavarur të nxënësve/eve, p.sh. përmes një numri të caktuar të piktogramave (simboleve) në lidhje me udhëzime dhe detyra (p.sh. ✍ = shkruaj!) si dhe me një paraqitje tepër të kapshme të ushtrimeve.					
16.1.1.11	Abetarja përmban detyra/ushtrime shtesë për nxënës/e të dobët e të shkëlqyeshëm (diferencimi i brendshëm, kr. standardin 6.7).					
16.1.1.12	Abetarja ka parasysh që premiset dhe njohuritë para-prake të nxënësve/eve në fushën e shkrimit e të leximit në fillim të klasës së parë ndryshojnë shumë; për ta përballuar këtë heterogjenitet, abetarja ofron ndihma dhe materiale për diferencimin e brendshëm dhe për individualizimin e mësimin (p.sh. një tabelë me të gjitha shkronjat si mbështetje e të mësuarit në mënyrë të pavarur).					
16.1.1.13	Aftësia e leximit dhe e shkrimit ushtrohet qysh prej fillimit në mënyrë intensive dhe efektive përmes një trajnimit dhe një përsëritjeje sistematike, të larmishme dhe motivuese të grafemave (përk.: të korrelacioneve midis fonemave dhe grafemave) të mësuar.					
16.1.1.14	Qysh prej fillimit ushtrohet, përveç aftësisë së dekodimit, edhe aftësia e të kuptuarit. Këtij qëllimi (d.m.th. që nxënësit/et edhe të mendojnë për atë që kanë lexuar) shërbejnë p.sh. shmangia e teksteve të pakuptimta, përdorimi i fjalive korrekte nga ana sintaksore (të plotësuara ndoshta me simbole apo piktura për fjalë që ende s'mund të lexohen) si dhe udhëzime dhe pyetje përkatëse.					
16.1.1.15	Abetarja kontribuon, përmes një vargu sugjerimesh dhe detyrash konkrete dhe të përshtatshme për moshën, në zhvillimin e ndërgjegjes gjuhësore dhe të aftësive reflektive lidhur me gjuhën.					
16.1.1.16	Abetarja përmban – në materialin për nxënësit/et si dhe në librin e mësuesit/es – sugjerime, udhëzime dhe ushtrime të mjaftueshme për ta zhvilluar dhe për ta ushtruar, njëkohësisht me aftësinë e leximit, edhe aftësinë e shkrimit (duke përfshirë edhe aspektet motorike të të shkruarit).					
16.1.1.17	Në libër të mësuesit/es tematizohen, përveç udhëzimeve për punën konkrete me abetaren, edhe aspekte të rëndësishme të mëtejshme (zhvillimi i ndërgjegjes fonologjike, rëndësia që fëmijët që herët zhvillojnë kompetenca literale (anglisht: <i>early literacy</i> ) e që të fitojnë që herët përvoja me shkrimin në situata të ndryshme etj.)					

Vlera e përgjithshme për standardin 16.1.1 ({16.1.1.1 – 16.1.1.17} : 17) = \_\_\_\_\_

## 16.1.2 Standarde plotësuese për *librin e leximit*

Shënim: Me kujdes të veçantë duhet sqaruar së pari *shumëperspektiviteti i përmbajtjes* së libër leximit. Krahaso për këtë standardet 9, 10 dhe 11 (lidhje me grupe të ndryshme etnike, me përvojat dhe me letërsitë e tyre; orientimi pas vlerave kyçe si edukim për pjekuri/pavarësi, tolerancë, kompetencë për dialog, kompetencë sociale, barazi gjinore etj.). Vëmendje të posaçme duhet kushtuar, pastaj, çështjes nëse tekste e përmbledhura në libër leximi i plotësojnë kriteret gjuhësore të përshkruara në standardin 8.

Nr.	<b>Tregues</b> (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.1.2.1	Pamja dhe paraqitja e teksteve letrare dhe jolettrare përputhet me moshën e nxënësve/eve për të cilët është konceptuar libri i leximit. Sidomos në librin e leximit për klasën e dytë largësia midis rreshtave, si dhe tipi dhe madhësia e shkronjave janë të përshtatshme; gjithashtu rreshtat në fillim, eventualisht, ndahen sipas njësive sintaksore apo kuptimore (kr. standardin 16.1.1.6).					
16.1.2.2	Gjuha e shkrimeve, veçanërisht në librat e leximit për klasat e ulëta, korrespondon me veçantitë gjuhësore të Kosovës (në rastin e shqipes: të qenët pranë e pranë të dialektit gegë e të gjuhës standarde) dhe kontribuon në mënyrë të kujdesshme, por sistematike, që nxënësit/et njihen me variantin standard (përveç kësaj, për aspektet gjuhësore kr. standardin 8).					
16.1.2.3	Libri i leximit kontribuon në zhvillimin e një kulture të të lexuarit e cila vazhdon edhe pas shkollës. Për këtë arsye ai përmban materiale, udhëzime, sugjerime dhe nxitje për leximin e mëtejshëm (jashtë- dhe passhkollor), si p.sh. pjesë a krerë tërheqës nga librat për fëmijë a për të rinj, informata e të dhëna bibliografike për libra të tillë, udhëzime për përdorimin e bibliotekave dhe të mediave të ndryshme (të shtypura a elektronike), informata dhe sugjerime në lidhje me vlerën dhe me faqet e leximit gjatë kohës së lirë.					
16.1.2.4	Libri i leximit mbështetet mbi një koncept të gjerë të leximit dhe mbi një kuptim të gjerë të kompetencave letrare, i cili përfshin edhe multimedialitetin e sotëm dhe kërkesat e literalitetit të lidhura me menaxhmentin e informatave (anglisht: information literacy); gjë që pasqyrohet në librin e mësuesit/es, në zgjedhjen e teksteve, në udhëzimet, sugjerimet dhe formulimet e detyrave.					
16.1.2.5	Libri i leximit përmban një spektër të gjerë të llojeve të teksteve të ndryshme; me qëllim që nxënësit/et të fitojnë kompetenca në menaxhmentin e mediave dhe të llojeve të teksteve të ndryshme (tekste letrare, tekste nga jeta e përditshme, grafikë, diagramë, websites etj.).					

16.1.2.6	Libri i leximit përmban udhëzime në lidhje me aspektet teknike të leximit, me strategji të të lexuarit dhe me mënyrat si duhet punuar me lloje tekstesh të caktuara (p.sh. me poezi, me tekste informative etj.). (Ky tregues nuk vlen, nëse kërkesat përkatëse janë plotësuar nga libri i gjuhës; shih 16.1.3).					
16.1.2.7	Libri i leximit përmban tekste, materiale dhe ushtrime, që e përkrahin në mënyrë efektive ndërtimin dhe zhvillimin e aspekteve të veçanta, të pjesshme, të kompetencës letrare, si p.sh.: saktësi, të kuptuarit e përmbajtjes, shpejtësi, modelim gjuhësor në lexim me zë të lartë etj. (Ky tregues nuk vlen, nëse kërkesat përkatëse janë plotësuar nga libri i gjuhës; shih 16.1.3).					
16.1.2.8	Përmes zgjedhjes së teksteve dhe përmes udhëzimeve dhe sugjerimeve të mëtejshme, libri i leximit krijon mundësi që nxënësit/et të mësohen në mënyrë autentike me funksione, modalitete dhe mënyra të ndryshme të leximit (leximi informativ, leximi zbavitës, leximi interpretues, leximi kritik etj.).					
16.1.2.9	Libri i leximit përmban një zgjedhje cilësore dhe të përshtatshme me moshën e nxënësve/eve me shembuj nga letërsia e popullit të vet, duke kontribuar kështu në formimin dhe edukimin letrar në gjuhën dhe kulturën e vet.					
16.1.2.10	Libri i leximit përmban edhe shembuj nga letërsitë e popujve e të kulturave të tjera, sidomos të atyre që jetojnë në Kosovë, dhe kultivon respektin ndaj të tjerëve dhe ndaj kulturës së tyre.					
16.1.2.11	Zgjedhja e teksteve orientohet drejt përvojave dhe interesave heterogjene të fëmijëve e të të rinjve me prejardhje familjare, sociale dhe kulturore të ndryshme, pas përvojave dhe interesave të ndryshme të vajzave e të djemve të grup-moshës për të cilin është konceptuar libri i leximit, si dhe drejt qëllimeve pedagogjike të mbirenditura (kr. standardet 5, 9-12).					
16.1.2.12	Libri i leximit përmban nxitje, pyetje, sugjerime dhe detyra interesante, tërheqëse dhe motivuese, të cilat i cytin nxënësit/et që të merren në mënyrë të thelluar me tekstet (p.sh. ilustrime, impulse për biseda dhe diskutime, sugjerime për komente/qëndrime me shkrim a me gojë, transformim i tekstit në një lloj teksti tjetër/në një pjesë teatrore/në një pikturë etj.). (Për sa i përket raportit midis teksteve dhe ilustrimeve, kr. edhe standardin 3.1).					
16.1.2.13	Libri i leximit përmban tekste me kompleksitet gjuhësor të ndryshëm (nëse është e mundshme, për secilën temë), duke lejuar dhe duke përkrahur me këtë diferencimin e brendshëm (kr. standarde 6.7 dhe 8.5).					
16.1.2.14	Niveli/shkalla e kompleksitetit apo e vështirësisë gjuhësore është shënuar në librin e leximit (si përkrahje e të mësuarit në mënyrë të pavarur të nxënësve/eve), apo është shënuar të paktën në librin e mësuesit/es					
16.1.2.15	Libri i leximit kontribuon, përmes teksteve, materialeve dhe udhëzimeve të përshtatshme, në zhvillimin e					



	ndërgjegjes gjuhësore (anglisht: language awareness) dhe të aftësive refleksive në lidhje me gjuhën.					
16.1.2.16	Libri i leximit i stimulon nxënësit/et, përmes teksteve, sugjerimeve dhe detyrave të përshtatshme, që ata të merren me gjuhë jo vetëm në mënyrë pasive, receptive, por edhe në mënyrë aktive, komunikative, vepruese dhe krijuese.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.1. 2 ({16.1.2.1 – 16.1.2.16} : 16) = \_\_\_\_\_**

### 16.1.3 Standarde plotësuese për librin e gjuhës

Shënim: Standardi vijues nisët nga koncepti a profili për libra gjuhe (dhe nga kërkesat përkatëse) siç ai është pranuar gjerësisht të paktën në hapësirat gjermanisht- dhe anglishtfolëse në 20 vitet e kaluara. Përmbajtjet e librit të gjuhës të jenë, sipas këtij koncepti, jo vetëm gramatika, të menduarit për gjuhë dhe rregulla të drejtshkrimit. Përkundrazi, libri i gjuhës duhet t'u referohet të gjitha fushave të mësimit gjuhësor (lexim, shkrim, të folur, aspekte formale (gramatikë, drejtshkrim), të menduarit për gjuhë etj.). Kështu libri i gjuhës e kupton vetveten në radhë të parë si medium a mjet ndihmës për t'i zhvilluar kompetencat gjuhësore të nxënësve/eve në të gjitha ato fushat. Një theks i veçantë dhe kryesor i vihet përkrahjes së pavarësisë së nxënësve/eve në lidhje me çështje gjuhësore. Këtij qëllimi i shërbejnë, ndër të tjera, udhëzimet në lidhje me dijeni procedurale (strategji të të mësuarit etj.) si dhe përgatitja, përpilimi dhe paraqitja e lëndës mësimore në një mënyrë e cila e mbështet të mësuarit në mënyrë vepruese, aktive dhe refleksive në situata motivuese dhe autentike.

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.1.3.1	Teksti shkollor i gjuhës e ndihmon në mënyrë efektive ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave gjuhësore në të gjitha fushat e mësimit gjuhësor (lexim, shkrim, të folur, gramatikë, drejtshkrim, të menduarit për gjuhën; ndoshta edhe aspekte në lidhje me media (mjete informimi), për aq sa ato janë objekt i mësimit gjuhësor).					
16.1.3.2	Teksti shkollor i gjuhës ua paraqet nxënësve/eve gjuhën, dialektet dhe çështjet gjuhësore si diçka interesante, tërheqëse dhe të rëndësishme, duke ua ofruar nxënësve/eve hyrje, materiale, sugjerime dhe pyetje, të cilat u lejojnë atyre dhe i motivojnë ata që të merren me çështje gjuhësore në mënyrë zbuluese, vepruese dhe sa më të pavarur.					
16.1.3.3	Përmes materialeve, pyetjeve dhe sugjerimeve të përshtatshme, teksti shkollor i gjuhës i nxit nxënësit/et drejt një sjelljeje të ndërgjegjshme, kritike e reflektuese ndaj gjuhës në të gjitha fushat e përdorimit të saj, duke zhvilluar dhe duke përforcuar njëkohësisht aftësitë metakognitive, refleksive të tyre.					
16.1.3.4	Teksti shkollor i gjuhës i përfill veçantitë gjuhësore të Kosovës (p.sh. të qenët pranë e pranë të dialektit gegë e të gjuhës standarde të shqipfolësit) dhe kontribuon në mënyrë të kujdesshme, por sistematike, që nxënësit/et njihen me variantin standard dhe ta zotërojnë atë.					

16.1.3.5	Në materialet, sugjerimet dhe detyrat e përmbledhura në të, libri i gjuhës u referohet botës reale dhe mjedisit gjuhësor të nxënësve/eve si dhe situatave autentike nga jeta e tyre (duke marrë parasysh heterogjenitetin e botëve reale dhe të ambienteve gjuhësore të nxënësve/eve të ndryshëm).					
16.1.3.6	Teksti shkollor i gjuhës e nxit pavarësinë e nxënësve/eve, duke u dhënë dhe duke u mësuar dijeni procedurale, strategji dhe ndihma të të mësuarit si dhe teknika pune, në lidhje me fushat e ndryshme të përdorimit të gjuhës e të të menduarit për çështje gjuhësore.					
16.1.3.7	Teksti shkollor i gjuhës përmban një sasi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për moshën në fjalë të ushtrimeve tërheqëse dhe motivuese, me të cilat lëndët e mësuara mund të ushtrohen, të thellohen e të aplikohen me sukses e në mënyrë të larmishme.					
16.1.3.8	Teksti shkollor i gjuhës përmban një numër të mjaftueshëm të materialeve, sugjerimeve, detyrave që e lejojnë dhe e përkrahin të mësuarit në mënyrë vepruese, zbuluese, eksperimentuese (në vend të stërvitjes së thatë të normave të parashtruara dhe të një mësimi sidomos riprodhues), kjo edhe në lidhje me mësimin e gramatikës (i cili duhet të zbatohet në kontekste vepruese, zbuluese ose lidhur me përpilimin a përpunimin e teksteve) dhe në lidhje me mësimin e gjuhës standarde (krahasime me dialektin, hulumtime nga ana e nxënësve/eve etj.).					
16.1.3.9	Teksti shkollor i gjuhës është i përshtatshëm për diferencimin e brendshëm dhe për mësimin individual, duke ofruar hyrje, detyra dhe ushtrime në nivele të ndryshme, të diferencuara sipas vështirësisë (kr. edhe standarde 6.6 und 6.7).					
16.1.3.10	Teksti shkollor i gjuhës krijon mundësi dhe tregon teknika dhe mënyra për (vetë-)vlerësimin e rezultateve të arritshmërisë (vetëkontrolli i nxënësve/eve kudo ku është i mundur, por edhe – në komentarin apo doracakun – udhëzime dhe sugjerime për mësuesin/en).					
16.1.3.11	Detyrat, sugjerimet për punë të mëtejshme, si dhe ushtrimet dhe trajnimet janë përpiluar në mënyrë që ta nxitin komunikimin dhe ndërveprimin e nxënësve/eve.					
16.1.3.12	Teksti shkollor i gjuhës i referohet shumëgjuhësisë së Kosovës (duke përfshirë edhe dialektet e ndryshme) dhe e shfrytëzon atë, si dhe njohuritë në gjuhët e huaja të mësuara në shkollë, si rast për situata mësimore tërheqëse dhe autentike në fushën e të menduarit për gjuhë dhe të zhvillimit të ndërgjegjes gjuhësore (anglisht: language awareness); kjo p.sh. përmes mbledhjeve dhe krahasimeve të fjalëve nga gjuhët dhe dialektet e ndryshme etj. (Kr. edhe qëllimet përkatëse të portofolit evropian të gjuhëve.)					
16.1.3.13	Teksti shkollor i gjuhës përmban sugjerime dhe pikënisje për një mësim të orientuar drejt nxënësve/eve					

	dhe burimeve të tyre (në vend të paradigmës tradicionale me mësuesin/en në qendër), sidomos përmes sugjerimeve për integrimin dhe shfrytëzimin e kompetencave dhe të burimeve (shumë-)gjuhësore të nxënësve/eve.					
16.1.3.14	Teksti shkollor i gjuhës u referohet masmediave dhe mjeteve elektronike të reja (televizor, kompjuter, internet, e-majl, SMS etj.), duke integruar sugjerime dhe detyra të lidhura me to (p.sh. për sa i përket gjuhës së veçantë të SMS-eve, anglicizmave në gjuhën e sotme, dallimeve mes e-majleve dhe letrave tradicionale etj.).					
16.1.3.15	Në kuptim të një didaktike gjuhësore të përgjithshme, gjithëpërfshirëse, dhe të një lehtësimit të të mësuarit, libri i gjuhës përfill, për sa i përket konceptit, terminologjisë dhe aspekteve didaktike, një koncept të mbirenditur, i cili vlen edhe për tekstet shkollore të gjuhëve të huaja. (Ky tregues nuk vlen në qoftë se ende nuk ekziston një koncept i mbirenditur i tillë).					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.1. 3 ({16.1.3.1 – 16.1.3.15} : 15) = \_\_\_\_\_**

## 16.2 Gjuhët e huaja

**Shënim:** Teksti shkollor për gjuhë të huaj duhet të ketë përmbajtje të integruar që zhvillojnë aftësitë e nxënësve për komunikim dhe ndërveprim përmes zhvillimit të shkathtësive gjuhësore: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit si dhe të kuptuarit e sistemit gjuhësor përmes përdorimit. Teksti shkollor duhet të ketë tema me përmbajtje ndër kurrikulare dhe ekstra kurrikulare në mënyrë që mësimi dhe përdorimi i gjuhës së huaj të shihet si mjet dhe qëllim, jo qëllim për vete.

Teksti shkollor për gjuhë të huaj duhet të reflektojë shembuj pozitiv, përmes të cilëve bartet respekti për kultura dhe për popuj të ndryshëm të botës. Njëkohësisht teksti shkollor duhet të pasqyrojë dimensione të ndryshme kulturore, duke promovuar vlera të ndërsjella për demokraci, pavarësi, tolerancë dhe barazi gjinore.

Për sa i përket didaktikës, zhvillimi duhet ndjekur në mënyrë sistematike, hap pas hapi, prej së thjeshtës deri në fenomene më komplekse, me përmbajtje, detyra dhe ushtrime tërheqëse, të cilat sigurojnë edhe përsëritjen, thellimin dhe aplikimin e njohurive të fituara.

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.2.1	Përmbajtja e tekstit është e afërt me jetën, mbështetet në realitetin dhe është në fushën e interesimit të nxënësve/eve.					
16.2.2	Shkathtësitë e ndryshme të komunikimit : të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit si dhe të kuptuarit e sistemit gjuhësor përfillen dhe zhvillohen në mënyrë të baraspeshuar					
16.2.3	Përmbajtjet e sistemit gjuhësor ofrohen duke pasur parasysh moshën dhe aftësitë psikofizike të nxënësve/eve.					
16.2.4	Teksti shkollor ofron tema përmes të cilave nxënësit/et e pasurojnë dhe thellojnë vazhdimisht dhe në mënyrë sistematike fjalorin e tyre me fjalë dhe shprehje të reja.					
16.2.4	Teksti shkollor ofron mundësi që nxënësit/et të kuptojnë përmes të dëgjuarit, të shprehen lirshëm dhe kuptueshëm					
16.2.5	Teksti shkollor ofron tekste, përmes të cilave nxënësit/et marrin dhe kuptojnë informacione të ndryshme për gjuhën dhe kulturën përkatëse duke lexuar.					
16.2.6	Teksti shkollor kultivon të lexuarit shprehës (ekspresiv), përmes elementeve gjuhësore si intonacion, ritëm, melodi, timbër, shenja të pikësimit.					
16.2.7	Teksti shkollor ofron shembuj dhe detyra ku nxënësit/et zhvillojnë shkathtësitë e të shkruarit të drejtë dhe të kuptueshëm					
16.2.8	Teksti shkollor ofron përmbajtje, tema dhe detyra nga					

	lëndët tjera në kuadër të kurrikulit përkatës					
16.2.9	Teksti shkollor përmes gjuhës së tij, fotografive dhe ilustrimeve përkrah barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, tolerancën dhe kultivon edukimin ndërkulturor.					
16.2.10	Teksti shkollor kontribuon në njohjen e kulturës së vendit përkatës në raport me aspektin e ndërsjellë kulturor.					
16.2.11	Teksti shkollor ofron tema për të mësuar në mënyrë sistematike, të cilat e lehtësojnë komunikimin ndërkulturor.					
16.2.12	Përmbajtja e tekstit shkollor, struktura dhe koncepti didaktik i tij ( përfshirë temat, detyrat, pyetjet, ushtrimet) është në funksion të zhvillimit sistematik të shkathtësive gjuhësore në gjuhën e huaj dhe të komunikimit në të					
16.2.13	Teksti shkollor ofron përmbajtje, tema dhe detyra që nxitin dëshirën e nxënësit/es për të mësuar gjuhën e huaj.					
16.2.14	Teksti shkollor ofron dhe paraqet situata, shembuj, ushtrime, pyetje dhe detyra, të cilat e favorizojnë punën e pavarur, aktive të nxënësve/eve në procesin mësimor.					
16.2.15	Teksti shkollor i nxit nxënësit/et për bashkëpunim dhe për punë në grupe me qëllim të përfshirjes së gjithë nxënësve/eve në aktivitetet e parapara për mësim ndërveprues.					
16.2.16	Teksti shkollor ofron dhe paraqet situata, shembuj, ushtrime, pyetje dhe detyra, të cilat e zhvillojnë imagjinatën dhe kreativitetin e nxënësve/eve					
16.2.17	Teksti shkollor jep shembuj për të mësuarit, ku nxënësi/ja përjeton atë që e mëson dhe e reflekton praktikisht përmes lojës ose të roleve të ndryshme si në klasë ashtu edhe në jetën e përditshme					
16.2.18	Teksti shkollor ofron detyra, ushtrime etj. Të mjaftueshme, të cilat e garantojnë përsëritjen dhe thellimin sistematik të njohurive të reja					
16.2.19	Temat, detyrat dhe ushtrimet në tekstin shkollor janë të renditura në shkallë të ndryshme të vështirësisë, duke filluar nga të thjeshtat deri te ato më të vështira.					
16.2.20	Teksti shkollor shoqërohet me mjete ndihmëse si CD, me fjalorth, fletore pune, etj. me qëllim që nxënësit/et më lehtë ta përvetësojnë gjuhën.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.2. ({16.2.1 – 16.2.20}) : 20) = \_\_\_\_\_**

### 16.3. Gjuha shqipe për komunitete joshqiptare

**Shënim:** Teksti shkollor i gjuhës shqipe për komunitete jo shqiptare duhet të ketë përmbajtje të integruar që zhvillojnë aftësitë e nxënësve për komunikim dhe ndërveprim, përmes zhvillimit të shkathtësive gjuhësore: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit si dhe të kuptuarit e sistemit gjuhësor përmes përdorimit. Teksti shkollor duhet të ketë tema me përmbajtje ndër lëndore dhe ndër kulturore, duke pasur parasysh momente të veçanta (festat e ndryshme). Teksti shkollor gjithashtu duhet të reflektojë shembuj pozitiv, përmes të cilëve bartet respekti për kultura dhe për popuj të ndryshëm të Kosovës e të botës.

Teksti shkollor duhet ti përgjigjet moshës së caktuar, duke përfshirë metodologjinë bashkëkohore të përdorimit të tij.

Teksti të sjellë kënaqësi te nxënësit/et duke i nxitur për studime të mëtejme për gjuhën shqipe dhe në gjuhën shqipe.

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.3.1	Teksti shkollor ndihmon në mënyrë efektive ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave gjuhësore në të gjitha fushat: dëgjim, të folur, lexim, shkrim, dhe sistemin gjuhësorë përmes përdorimit.					
16.3.2	Teksti shkollor zhvillon të menduarit për gjuhën, aspektet e komunikimit, korrelacionin e gjuhës amtare me gjuhën shqipe dhe krahasimin me të.					
16.3.3	Teksti shkollor shoqërohet me figura, fotografi, pamje nga ambientet e Kosovës dhe trashëgimia kulturore, të shoqëruara me tekste të shkurtra që zgjojnë interesimin dhe kureshtjen e nxënësit/es dhe e motivojnë atë që të merret me gjuhën shqipe në mënyrë vepruese, hulumtuese dhe argëtuese.					
16.3.4	Teksti shkollor përfill veçantitë gjuhësore të grupeve etnike të ndryshme, në funksion të integritetit dhe krahasimit të kulturave të ndryshme, me qëllim të edukimit në frymën e tolerancës, respektimit dhe komunikimit ndër-etnik.					
16.3.5	Teksti shkollor është shkruar me një shkrim të lexueshëm mirë e të përshtatshëm nga ana tipografike – veçanërisht në fillim, me shkronja të mëdha.					
16.3.6	Teksti shkollor përfshin njësitë dhe ushtrimet e përshtatura për moshën e nxënësit/es dhe trajton tema tërheqëse, të aplikueshme në komunikimin e përditshëm.					
16.3.7	Teksti shkollor është i përshtatshëm për mësimin individual dhe ofron figura me kuptim, vizatime, fotografi, detyra dhe ushtrime të ndryshme për nivelin					

	përkatës. Këto janë të klasifikuara sipas vështirësisë e të shoqëruara gjithmonë me fjalor përkatës të fjalëve dhe koncepteve të reja.					
16.3.8	Teksti shkollor përmban elemente nëpërmjet të cilave synohet që nxënësit/et të njoftohen me ligjshmëritë themelore të gjuhës letrare, krijimtarisë letrare dhe krijimtarisë kulturore të vendit.					
16.3.9	Teksti shkollor nxit nxënësit/et ta përdorin gjuhën shqipe nga kënaqësia si dhe në kontekstin edukativ e multikulturor.					
16.3.10	Teksti shkollor përmban tema të cilat korrespondojnë me njohuritë paraprake të gjuhës amtare dhe njohuritë e reja të gjuhës shqipe, përfshirë këtu krahasimin e fjalëve, dialekteve dhe kulturave të ndryshme.					
16.3.11	Teksti shkollor paraqet situata të cilat stimulojnë mendjen, kreativitetin dhe kureshtjen e nxënësit/es për të punuar në mënyrë të pavarur dhe ndërvepruese, p.sh. piktogramet (simbolet), vizatime për plotësim, udhëzime të kapshme për moshën e nxënësit/es (zhvillimi i mendimit kritik).					
16.3.12	Teksti shkollor ofron mundësi dhe teknika përmes të cilave nxënësit/et mund të vetëvlerësohen për arritjet në zotërimin e gjuhës shqipe.					
16.3.13	Teksti shkollor përmban materiale shtesë: fletë pune, teste, etj. për testimin në fund të kapitullit të caktuar.					
16.3.14	Teksti shkollor përmban detyra dhe udhëzime lidhur me shfrytëzimin e burimeve të sofistikuara të të mësuarit të gjuhës, siç janë: televizori, kompjuteri, interneti, si dhe shoqërohet me CD, fjalorth etj.					
16.3.15	Teksti shkollor përfshin doracakun- komentarin me udhëzime dhe sugjerime të punës së mësimdhënësit/es me libër.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.3 ({16.3.1 – 16.3.15} : 15) = \_\_\_\_\_**



## 16.4 Matematika

**Shënim:** Standardi dhe treguesit vijues i referohen konceptit aktual nga ana shkencore e didaktike dhe të njohur gjerësisht, që të mësuarit në lëndën matematikë nuk kufizohet në të numëruarit dhe të llogariturit, por përfshin një fushë më të gjerë (kuptimi i numrave dhe i operacioneve matematikore, procedime a mënyra të ndryshme të të llogariturit, gjeometri, njësi matëse (kg, cm, l, etj.), detyra matematike me tekst, zbatime/përdorime etj.). Në këtë, teksti shkollor i matematikës luan rolin e mediumit e të mjetit ndihmës, i cili kontribuon në zhvillimin e njohurive, kompetencave dhe të aftësive matematikore të nxënësve/eve në të gjitha ato fusha dhe në përkrahjen e pavarësisë së tyre ndaj pyetjeve/problemeve matematikore. Këtij qëllimi shërbejnë, ndër të tjera, udhëzimet në lidhje me dijeni procedurale (strategji të të mësuarit etj.) si dhe përgatitja, përpilimi dhe paraqitja e lëndës mësimore në një mënyrë e cila e mbështet të mësuarit në mënyrë vepruese, aktive dhe refleksive në situata motivuese dhe autentike.

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.4.1	Për sa i përket konceptit didaktik, terminologjisë së përdorur si dhe mënyrës se si prezantohen/paraqiten detyrat dhe si duhet punuar, teksti shkollor i matematikës është në përputhje me konceptin e përgjithshëm, koherent të teksteve shkollore të matematikës të shkollave të Kosovës (kr. standardin 1.3)					
16.4.2	Ndërtimi dhe struktura e tekstit shkollor të matematikës dhe të komentarit/doracakut përkatës janë të qartë e të kapshëm dhe lejojnë një orientim të shpejtë e të lehtë si dhe zbatimin pa probleme të lëndës së trajtuar gjatë mësimit.					
16.4.3	Format, mënyrat, formatet dhe tipat si prezantohen çështjet dhe detyrat matematikore janë të thjeshta, të sakta dhe koherente (përdorim i disahershëm i të njëjtit tip a format; shmangie e një shumëllojshmërie të kote; me qëllim që të përmirësohen orientimi i nxënësve/eve dhe të punuarit e tyre në mënyrë të pavarur).					
16.4.4	Gjuha e përdorur në udhëzimet dhe në llogaritjet/detyrat me tekst është e thjeshtë dhe e orientuar drejt gjuhës së përditshme (në trajtën standarde); teksti shkollor u shmanget fjalëve të rralla dhe ndërtimeve sintaksore të pazakonshme.					
16.4.5	Teksti shkollor i matematikës e përkrah në mënyrë efektive zhvillimin dhe zgjerimin e kompetencave matematikore në të gjitha fushat e mësimit të matematikës (kup-					

	timin e numrave e të operacioneve, njohjen e procedimeve apo mënyrave të ndryshme të të llogariturit, zbatimet/përdorimet etj., shih më lart).					
16.4.6	Kuptimi/koncepti i numrave dhe i bashkësive matematikore, si dhe kuptimi i relacioneve, operacioneve, analizave a zbërthimeve etj. ndërtohet dhe zhvillohet hap pas hapi në mënyrë të kujdesshme, serioze dhe kështu që nxënësit/et të jenë sa më shumë aktivë dhe mund të veprojnë vetë.					
16.4.7	Teksti shkollor i matematikës ofron materiale, sugjerime dhe ushtrime për secilën fazë, fushë dhe dimension vijues të të mësuarit: 1.) Mbivështrim, hyrje në problem, 2.) Kuptim, thellim, 3.) Trajnim efektiv i shkakësisë, 4.) Zbatim/përdorim/transferim.					
16.4.8	Në detyrat dhe sugjerimet e tij, teksti shkollor i matematikës u referohet, kudo ku është e mundur dhe me kuptim, fenomeneve matematikore që gjenden në mjedisin real dhe në botën autentike të nxënësve/eve.					
16.4.9	Teksti shkollor i matematikës u paraqet nxënësve/eve probleme dhe metoda matematikore si diçka interesante, tërheqëse duke iu ofruar nxënësve/eve mundësi dhe sugjerime të ndryshme për të mësuarit në mënyrë hulumtuese, zbuluese e të pavarur.					
16.4.10	Përmes materialeve, sugjerimeve dhe detyrave të përshtatshme, teksti shkollor i matematikës i nxit nxënësit/et drejt një sjelljeje të ndërgjegjshme, kritike dhe të reflektuar ndaj matematikës në të gjitha fushat e përdorimit të saj, duke zhvilluar njëkohësisht aftësitë kognitive dhe refleksive të nxënësve/eve.					
16.04.11	Teksti shkollor i matematikës i ndjek dhe përfill parimet aktuale të didaktikës së matematikës, d.m.th. të mësuarit në mënyrë aktive, vetëvepruese dhe zbuluese, të orientuar drejt procesit (jo rezultatit) dhe drejt kuptimit (jo zbatimit/riprodhimit automatik).					
16.4.12	Teksti shkollor i matematikës i përkrah aftësitë e nxënësve/eve për të zgjidhur probleme, si dhe aftësitë kognitive dhe strategjike të nxënësve; p.sh. duke u parashtruar detyra «të hapura», detyra me më shumë se vetëm një zgjidhje dhe duke i nxitur që të provojnë e të përshkruajnë rrugë dhe strategji vetjake të të mësuarit.					
16.4.13	Teksti shkollor i matematikës e përkrah dhe e bën të mundur të mësuarit e nxënësve/eve në mënyrë të pavarur, p.sh. përmes formulimeve të thjeshta e të kapshme të detyrave (duke përdorur ndoshta edhe simbole të kapshme) si dhe përmes tipave, formave dhe formateve të kapshme e të përdorura disa herë të ushtrimeve (kr. edhe standardin 16.3.3).					
16.4.14	Teksti shkollor i matematikës e përkrah dhe e bën të mundur të mësuarit të nxënësve/eve në mënyrë të pavarur, duke u vënë në dispozicion dijeni procedurale, strategji, ndihma dhe teknika të të punuarit lidhur me lëmenjtë e ndryshëm të të punuarit e të të menduarit në fushën e matematikës.					

16.4.15	Teksti shkollor i matematikës përmban një sasi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për moshën në fjalë, të ushtrimeve dhe të trajnimeve tërheqëse dhe motivuese me të cilat lëndët e mësuara mund të ushtrohen, të thellohen e të zbatohen/aplikohen në mënyrë të suksesshme e të larmishme.					
16.4.16	Teksti shkollor i matematikës përmban sugjerime dhe pikënisje për një mësim të orientuar drejt nxënësve/eve dhe burimeve të tyre, sidomos përmes sugjerimeve për integrimin dhe shfrytëzimin e njohurive matematikore para- dhe jashtëshkollore të nxënësve/eve.					
16.4.17	Detyrat, sugjerimet për punë të mëtejshme, ushtrimet dhe trajnimet janë përpiluar, kudo ku është e mundur dhe me kuptim, në mënyrë që ta nxitin komunikimin dhe ndërveprimin e nxënësve/eve.					
16.4.18	Teksti shkollor i matematikës është i përshtatshëm për diferencimin e brendshëm dhe për mësimin individualizues, duke ofruar hyrje, detyra dhe ushtrime mbi nivele të ndryshme, të diferencuara sipas vështirësisë dhe kërkesave (kr. edhe standarde 6.6 und 6.7).					
16.4.19	Në rastin e detyrave/ushtimeve që paraqiten mbi nivele të ndryshme (në kuptimin e diferencimit të brendshëm), shkallët/nivelet e vështirësisë janë të shënuara në mënyrë të kapshme/të dallueshme me qëllim që nxënësit/et mund të orientohen në mënyrë të pavarur.					
16.4.20	Teksti shkollor i matematikës krijon mundësi dhe tregon teknika dhe mënyra për (vetë-)vlerësimin e arritjes së qëllimeve (vetëkontroll i nxënësve/eve kudo ku është i mundur, por edhe – në komentarin apo doracakun – udhëzime dhe sugjerime për mësuesin/en).					
<b>Treguesit vijues vlejné sidomos për librat fillestarë të matematikës</b>						
16.4.21	Teksti shkollor i matematikës kujdeset dhe siguron (eventualisht përmes udhëzimeve përkatëse në komentarin) që fëmijët të kuptojnë që herët natyrën (strukturën, ndërtimin), funksionet dhe mundësitë e matematikës. (Mbi bazë të këtij kuptimi, proceset e të mësuarit në lëndën matematikë marrin një motivim të brendshëm, primar, dhe i shmangen rrezikut që mësimi të degjenerohet në një stërvitje mekanike.)					
16.4.22	Tekstet dhe numrat janë shkruar me një shkrim të lexueshëm mirë e të përshtatshëm nga ana tipografike, si dhe me shkronja mjaft të mëdha dhe me largësi të mjaftueshme mes rreshtave, kjo për ta lehtësuar orientimin e nxënësve/eve në secilën faqe.					
16.4.23	Sidomos për fazën fillestare, gjatë secilës nxënësit/et nuk zotërojnë ende të gjithë numrat dhe shkronjat, teksti shkollor i matematikës ofron shumë fotografi, piktura etj., si dhe sugjerime përkatëse në komantar, të cilat i nxitin nxënësit/et, përmes mjeteve grafike dhe vizuale, që të interesohen, të mendojnë e të komunikojnë me njëri-tjetrin që herët për fenomene matematikore dhe gjeometrike.					
16.4.24	Teksti shkollor i matematikës ofron (edhe në komenta-					

	rin) materiale dhe sugjerime të mjaftueshme për të zhvilluar, njëkohësisht me aftësitë matematikore edhe aftësi dhe strategji specifike të të lexuarit dhe të të shkruarit, që janë me rëndësi për lëndën matematikë.					
--	---	--	--	--	--	--

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.4 ({16.4.1 - 16.4.20} : 20); në rastin e teksteve shkollore fillestare të matematikës ({16.4.1 - 16.4.24} : 24) = \_\_\_\_\_**

## 16.5 Shkencat e natyrës

(Shkencat e natyrës të integruara në lëndën *Njeriu dhe natyra 1-5*; biologji, fizikë, kimi, astronomi dhe gjeografi në nivelin e parë si dhe shkencat e natyrës si lëndë të veçanta në nivelin e dytë dhe të tretë; biologji, fizikë, kimi dhe astronomi si dhe gjeografi /vetëm për nivelin e dytë/)

**Shënim:** Tekstet shkollore nga lëmi i shkencave të natyrës luajnë rolin e mediumit, mjetit ndihmës dhe kontribuojnë në zhvillimin e njohurive, kompetencave dhe të aftësive të nxënësve/eve në aspekte të ndryshme të studimit të natyrës. Ato u ndihmojnë nxënësve/eve në krijimin e vetëdijes për ndërtimin dhe funksionimin e organizmave të gjallë, njohjen e ligjeve themelore të proceseve jetësore, vrojtimin e dukurive fizike dhe kimike, unitetin e materies dhe pozitën e Tokës në gjithësi. Tekstet shkollore u ndihmojnë nxënësve/eve, në punë të pavarur teorike, eksperimentale dhe praktike, zhvillimin e shkathtësive dhe të shprehive të përhershme, për të matur, për përpunimin e të dhënave eksperimentale, për zbatimin e tyre në situata konkrete, të menduarit kritik, aftësimin për të përdorë literaturë dhe burime të tjera për nxënie. Këtij qëllimi i shërbejnë udhëzimet në lidhje me strategjitë e të mësuarit, përgatitja, përpilimi dhe paraqitja e lëndës mësimore në atë mënyrë e cila e mbështet të mësuarit në mënyrë vepruese, aktive dhe motivuese.

Nr.	<b>Tregues</b> (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.5.1	Ndërtimi dhe struktura didaktike e tekstit shkollor të shkencave të natyrës është i qartë, i kapshëm dhe ofron orientim të lehtë dhe zbatim praktik të lëndës së trajtuar gjatë mësimit.					
16.5.2	Format, mënyrat dhe ecuritë e paraqitjes së ligjshmërive që prezantohen në tekstin shkollor të shkencave të natyrës janë të thjeshta, të sakta dhe koherente.					
16.5.3	Teksti shkollor i shkencave të natyrës, në mënyrë efektive, u referohet arritjeve më të reja shkencore nga lëmi përkatës.					
16.5.4	Në tekstin shkollor të shkencave të natyrës, përfitimi i formulave, i relacioneve veprimeve matematikore, analizave numerike, ndërtohet dhe zhvillohet hap pas hapi pa kapërcime, në mënyrë të kujdesshme dhe jo imponuese me qëllim që nxënësit/et të jenë sa më shumë aktivë dhe të mund të veprojnë në mënyrë të pavarur.					
16.5.5	Teksti shkollor i shkencave të natyrës ofron materiale, sugjerime, prova, ushtrime, detyra,					

	eksperimente për secilin nivel të të mësuarit: 1.) njohje, 2.) kuptim, 3.) zbatim, 4) mendim kritik (analizë, sintezë, vlerësim, qëndrim dhe vlerë).					
16.5.6	Realizimi i objektivave të përgjithshëm të programit në tekstin shkollor të shkencave të natyrës, për secilin nivel të të mësuarit: njohje, kuptim, zbatim, mendim kritik ( analizë, sintezë, vlerësim) kontrollohet në fund të çdo tërësie programore me kërkesa të parashtruara që u bëhen nxënësve/eve.					
16.5.7	Teksti shkollor i shkencave të natyrës u ofron nxënësve/eve probleme, metoda matematikore, zgjidhje interesante, tërheqëse, por edhe mundësi dhe sugjerime të ndryshme për të mësuarit në mënyrë hulumtuese, zbuluese e të pavarur.					
16.5.8	Në tekstin shkollor të shkencave të natyrës paraqitën ecuri të ndryshme deri te i njëjti përfundim, paraqiten përfundime të nxjerra nga provat, demonstrimet, matjet eksperimentale dhe vrojttimeve dhe zgjidhje të detyrave me ecuri të ndryshme, që nxisin strategji vetjake të të mësuarit.					
16.5.9	Teksti shkollor i shkencave të natyrës përmes demonstrimeve, eksperimenteve, matjeve, vrojttimeve në terren, vrojttimeve me teleskop në qiell të hapur dhe detyrave tipike nxënësve/eve u ofrojnë mundësinë e të mësuarit në mënyrë të pavarur në përputhje me moshën e tyre.					
16.5.10	Teksti shkollor i shkencave të natyrës përmban sasi të mjaftueshme, të ushtrimeve, detyrave, provave, demonstrimeve, eksperimenteve që janë motivuese dhe mundësojnë thellimin dhe zbatimin e njohurive të fituara në jetën e përditshme.					
16.5.11	Detyrat, sugjerimet për punë të mëtejshme, ushtrimet, provat, demonstrimet dhe eksperimentet në tekstin shkollor të shkencave të natyrës janë përpiluar, në mënyrë që ta nxitin komunikimin dhe ndërveprimin e nxënësve/eve.					
16.5.12	Teksti shkollor i shkencave të natyrës është i përshtatshëm për diferencimin e brendshëm të nxënësve/eve dhe për mësimin individual, sepse ofron detyra, ushtrime, prova, demonstrime, eksperimente dhe vrojtme të niveleve të ndryshme, sipas vështirësisë dhe kërkesave.					
16.5.13	Teksti shkollor i shkencave të natyrës u ofron nxënësve/eve, teknika dhe mënyra për vetëvlerësimin e arritjes së qëllimeve dhe objektivave të përgjithshëm.					
16.5.14	Ngarkesat (vëllimi) e njësive mësimore në tekstin shkollor të shkencave të natyrës janë të baraspeshuara në mes vetes, në përputhje me lëndën mësimore dhe aftësitë kognitive/njohëse të nxënësve/eve.					
16.5.15	Në fund të tekstit shkollor të shkencave të natyrës është fjalori përmbledhës i termave dhe koncepteve kryesore të trajtuara, si dhe indeksi i termave					

	shkencorë.					
16.5.16	Detyrat, provat, demonstrimet, eksperimentet, matjet e thjeshta, vrojtimit në qiell në tekstin shkollor të shkencave të natyrës u referohen, vazhdimisht dhe me kuptim, dukurive natyrore që gjenden në mjedisin jetësor dhe në botën autentike të nxënësve/eve.					
16.5.17	Përmes materialeve, sugjerimeve, ushtrimeve, detyrave, provave, demonstrimeve dhe eksperimenteve të përshtatshme, teksti shkollor të shkencave të natyrës e nxit zhvillimin e aftësive njohëse, emocionale dhe psikomotorike të nxënësve/eve.					
16.5.18	Në tekstin shkollor paraqiten rregullat e edukimit shëndetësor dhe të ruajtjes së mjedisit jetësor.					
16.5.19	Në tekstin shkollor të shkencave të natyrës shënimi i madhësive fizike, simboleve dhe formulave kimike, si dhe emërtimi i tyre është në përputhje me sistemin ndërkombëtar të njësive (SI) dhe rregullave të IUPAC-ut.					
16.5.20	Në tekstin shkollor të shkencave të natyrës paraqiten rregullat e sigurimit teknik: gjatë provave, demonstrimeve, eksperimenteve dhe vrojtimit në qiell, si dhe lista e materialeve të rrezikshme.					
<b>Treguesit vijues vlejné për tekstet shkollorë të shkencave të integruara në lëndën Njeriu dhe Natyra.</b>						
16. 5.21	Teksti shkollor Njeriu dhe natyra në të cilin janë të integruara shkencat e natyrës siguron që fëmijët të kuptojnë natyrën, proceset fizike, kimike dhe biologjike, mjedisin që i rrethon, ndërtimin dhe mbrojtjen e tij.					
16. 5.22	Ngarkesat (vëllimi) e njësive mësimore në tekstin shkollor Njeriu dhe natyra janë të baraspeshuara, me qëllim që të nxënësit/et të mos krijohet ndjenjë e monotonisë, kurse zgjedhja e mësimave është e kapshme dhe tërheqëse për grup moshën në fjalë.					
16. 5.23	Teksti shkollor <i>Njeriu dhe natyra</i> ofron shumë fotografi dhe piktura të cilat i nxisin ata të interesohen, të mendojnë e të komunikojnë me njëritjetrin për mjedisin që i rrethon, natyrën dhe dukuritë natyrore.					
16. 5.24	Teksti shkollor Njeriu dhe natyra ofron materiale të bollshme dhe sugjerime të mjaftueshme për të zhvilluar te nxënësit/et aftësi të interpretimit të drejtë të dukurive natyrore, proceseve fizike, kimike dhe biologjike të lidhura me to, ndërtimit të tokës, botës bimore dhe shtazore, burimeve të energjisë, ajrit, ujit, orientimit në hapësirë dhe trupave të sistemit diellor.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.5 ({16.5.1 - 16.5.20} : 20) = \_\_\_\_\_;**  
**në rastin e teksteve shkollorë të integruara në lëndën Njeriu dhe Natyra**  
**{16.5.21 - 16.5.24} : 4) = \_\_\_\_\_**

## 16.6 Shkencat shoqërore

### 16.6.1 Historia

Shënim: Tekstet shkollore të historisë duhet ta lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies së kësaj lënde. Ato duhet të jenë si një pikëmbështetje transparente e asaj se çfarë do të duhej të dinë dhe çfarë të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit/et, t'u ndihmojnë nxënësve/eve që duke kuptuar zhvillimet e proceseve, dukurive e fenomeneve të shoqërisë njerëzore të krijojnë një vetëdije historike, të kontribuojnë në zhvillimin e shkathtësive, aftësive dhe kompetencave të tyre, për të njohur dhe zbatuar procedura, për të gjykuar në mënyrë kritike për burime e pikëpamje të ndryshme dhe për t'i zbatuar ato në momente vendimmarrëse. Ato duhet ta nxisin zhvillimin e nxënësve/eve për të qenë qytetarë aktivë, të ndërgjegjshëm, në ndërtimin e një shoqërie demokratike.

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.6.1.1	Teksti shkollor i historisë sa i përket aspekteve didaktike, merr në konsiderim dhe respekton eksperiencat dhe njohuritë paraprake të nxënësve/eve.					
16.6.1.2	Teksti shkollor i historisë krijon lidhje me jetën e përditshme të nxënësve/eve.					
16.6.1.3	Teksti shkollor i historisë nxit të mësuarit e qartë dhe sipas shembujve dhe ndërlidh përmbajtjen me aftësitë/shprehitë e nxënësve/eve.					
16.6.1.4	Struktura e ndërtimit të tekstit të historisë dhe e doracakut për mësimdhënës/e është e qartë dhe e kapshme dhe lejon një orientim të shpejtë e të lehtë si dhe zbatimin pa problem të përmbajtjes së trajtuar gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies					
16.6.1.5	Teksti i historisë përkrah në mënyrë efektive ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave themelore të nxënësve/eve për të qenë qytetarë të përgjegjshëm, pjesëmarrës aktivë në ngritjen e shoqërisë demokratike.					
16.6.1.6	Përmes materialeve, pyetjeve dhe sugjerimeve të përshatshme, teksti i historisë i nxit nxënësit/et që në mënyrë sistematike t'i kultivojnë vlerat si mirëkuptimi, bashkëpunimi, toleranca, paqja, respektimi i të drejtave të njeriut si faktor vendimtar pajtimi, mirënjohje, mirëkuptimi e besimi të ndërsjellë midis njerëzve e popujve.					
16.6.1.7	Teksti i historisë përfill veçantitë etnike e kulturore të Kosovës dhe kontribuon në mënyrë të kujdesshme dhe sistematike në kultivimin dhe vënien në pah të					



	identitetit individual, kolektiv e kombëtar, nëpërmjet njohjes së trashëgimisë historike e kulturore lokale, regjionale, kombëtare, evropiane e botërore.					
16.6.1.8	Teksti i historisë pasqyron diversitetet dhe kohezionin dhe integrimin e grupeve dhe të kategorive shoqërore (gjinore, etnike, racore, fetare etj.) dhe përfill një qasje multikulturore e multiperspektive të të parit dhe të prezantuarit të ngjarjeve historike.					
16.6.1.9	Teksti i historisë përkrah pavarësinë e nxënësve/eve, duke u dhënë dhe duke u ofruar njohuri (dije) procedurale, strategji dhe ndihma të të mësuarit, si dhe teknika pune, në lidhje me çështjet historike dhe të menduarit historik.					
16.6.1.10	Teksti i historisë përmban një sasi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për moshën në fjalë, të ushtrimeve dhe të trajnimeve tërheqëse dhe motivuese që ndikojnë në përdorimin e burimeve didaktike të larmishme për njohjen e fakteve historike dhe të mësimit të tyre në mënyrë kritike e analitike.					
16.6.1.11	Teksti i historisë është i përshtatshëm për diferencim të brendshëm dhe për mësim individualizues me variacione të shumëllojshme që nxisin nxënësit/et për të ndërmarrë, sipas nivelit, mundësive dhe rrethanave që kanë, kërkime individuale, që stimulojnë kërkësinë dhe frymën e tyre vetëvepruese në vjeljen e të dhënave dhe në krijimin e mendimit të tyre sintetizues.					
16.6.1.12	Hartat, ilustrimet, fotot, karikaturat, tabelat statistikore janë informata konceptuese të tekstit që nxisin procesin e të kuptuarit e të analizuarit të ngjarjeve dhe të fenomeneve historike dhe njëkohësisht zhvillojnë të komunikuarit dhe të ndërvepruarit e nxënësve/eve (krahaso standardin 3).					
16.6.1.13	Teksti i historisë mundëson që të krijohet një ndërlidhje harmonike ndërmjet përdorimit të praktikave dhe metodologjive pedagogjike bashkëkohore, të përdorimit të teknologjisë së komunikimit dhe të informacionit multimedial dhe të muzeve e të arkivave.					
16.6.1.14	Teksti nxit përdorimin e potencialit edukativ ndërdisiplinor e shumëdisiplinor duke vendosur lidhje me disiplinat e tjera që përbëjnë tërësinë e programit (kurrikulit) shkollor, konkretisht me letërsinë, gjeografinë, shkencat shoqërore filozofinë, artet, përfshirë edhe disiplinat e shkencave ekzakta.					
16.6.1.15	Teksti i historisë jep mundësi dhe ofron mënyra e teknika për (vetë-)vlerësimin e arritjes së qëllimeve të nxënësve/eve (vetëkontrollin e nxënësve/eve) kudo ku është i mundur (si edhe në doracakun për mësuesin/en jep udhëzime e sugjerime përkatëse)					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.6.1 ({16.6.1 – 16.6.1.15} :15) = \_\_\_\_\_**

## 16.6.2 Edukata qytetare

**Shënim:** Teksti shkollor i edukatës qytetare të nxisë zhvillimin e fëmijëve e të të rinjve si qytetarë të ndërgjegjshëm për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, të pajisur me njohuri, me vlera dhe qëndrime të qytetarisë demokratike, paqësore, tolerantë, të hapur dhe të vullnetshëm për të marrë pjesë në jetën qytetare të vendit dhe për të kontribuar në ndërtimin e shoqërisë demokratike, ku respektohen të drejtat e secilit pa marrë parasysh përkatësinë gjinore, kombëtare, etnike, fetare dhe racore.

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.6.2.1	Teksti shkollor i edukatës qytetare është koherent për sa i përket konceptit didaktik, terminologjisë së përdorur si dhe mënyrës se si prezantohen/paraqiten çështjet e edukimit qytetar.					
16.6.2.2	Format dhe përmbajtjet e ushtrimeve dhe të detyrave që u jepen nxënësve/eve janë të qarta, koherente dhe funksionale me njësitë mësimore, me qëllimet e lëndës të parapara me plan dhe program mësimor të Republikës së Kosovës dhe me konceptin e përgjithshëm të edukatës qytetare.					
16.6.2.3	Ndërtimi dhe struktura e tekstit shkollor të edukatës qytetare dhe të doracakut për mësimdhënës/e është e qartë, e kapshme dhe e lejon orientimin e shpejtë e të lehtë si dhe zbatimin pa problem të përmbajtjes së trajtuar gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.					
16.6.2.4	Ilustrimet, fotografitë, tabelat statistikore, grafikët, kutizat/ insertet me shënime ose komente të veçanta, janë informata plotësuese të tekstit që ndihmojnë procesin e të kuptuarit, të komunikuarit dhe ndërvepruarit e nxënësve/eve.					
16.6.2.5	Teksti i edukatës qytetare jep mundësi dhe ofron mënyra e teknika për vetëvlerësimin e arritjes së qëllimeve të nxënësve/eve (vetëkontrollin e nxënësve/eve) kudo ku është i mundur (si edhe në doracakun për mësuesin/en jep udhëzime e sugjerime përkatëse).					
16.6.2.6	Teksti shkollor i edukatës qytetare për të ndihmuar të kuptuarit e qytetarisë demokratike, lejon hapësirë për punë të pavarur dhe nxit kureshtjen për shfrytëzimin e burimeve të tjera të shkruara ose të pashkruara, atyre elektronike si dhe atyre të mbledhura nga bisedat me qytetarë të zakonshëm, me anëtarë ose me drejtues të shoqatave, institucioneve etj.					
16.6.2.7	Teksti shkollor i edukatës qytetare e përkrah në					

	mënyrë efektive zhvillimin dhe zgjerimin e kompetencave të edukimit qytetar në të gjitha fushat e mësimi të edukatës qytetare.					
16.6.2.8	Teksti shkollor i edukatës qytetare u referohet strukturave, ngjarjeve dhe institucioneve shoqërore dhe u jep mundësi nxënësve/eve që të përballen më lehtë dhe të zgjidhin çështjet me të cilat preokupohen ata dhe komuniteti ku jetojnë.					
16.6.2.9	Përmes materies, sugjerimeve dhe detyrave të përshatshme, teksti shkollor i edukatës qytetare i nxit dhe i përgatit nxënësit/et për sjellje të ndërgjegjshme, kritike dhe të reflektuar ndaj problemeve shoqërore, si dhe i nxit për marrjen e përgjegjësive dhe të detyrave në familje, në shkollë apo në komunitetin ku jetojnë.					
16.6.2.10	Teksti shkollor i edukatës qytetare me shpjegime dhe shembuj adekuat nxit pjesëmarrjen aktive dhe vendim-marrjen në çështjet që kanë të bëjnë me të mirën dhe interesin personal e publik.					
16.6.2.11	Teksti shkollor i edukatës qytetare përmban informata dhe njohuri mbi vlerat dhe konceptet themelore të qytetarisë dhe nxit pjesëmarrjen në organizimet e jetës sociale, komunikimin dhe ndërveprimin në nivelin lokal, nacional dhe ndërkombëtar.					
16.6.2.12	Teksti shkollor i edukatës qytetare ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në edukimin për demokraci dhe vlera të shoqërisë demokratike, për të drejtat njerëzore, barazi qytetare, për luftë kundër diskriminimit gjinor, moshor, kulturor, gjuhësor, etnik, racor, fetar etj.					
16.6.2.13	Teksti shkollor i edukatës qytetare afirmon paqen, tolerancën, mirëkuptimin, komunikimin, dialogun dhe solidaritetin ndërmjet brezave, kulturave, feve, etnive dhe kombeve të ndryshme.					
16.6.2.14	Teksti shkollor i edukatës qytetare kultivon qëndrimet dhe vlerat humane dhe mjedisore, ngrit vetëdijen dhe nxit veprime që kanë për qëllim ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe të mjedisit jetësor.					
16.6.2.15	Teksti shkollor i edukatës qytetare promovon vlerat që kanë të bëjnë me zhvillimin personal dhe identitetin, me shëndetin dhe me kujdesin nga të gjitha format e rrezikut, me shkathësitë për jetën, dhe me format e parandalimit të konflikteve ose me zgjedhjen paqësore të tyre.					
16.6.2.16	Gjuha e përdorur në tekstin shkollor të edukatës qytetare, njësitë mësimore, ushtrimet dhe detyrat u përshtaten moshës dhe aftësive psikofizike të nxënësve/eve.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.6.2 ({16.6.2.1 – 16.6.2.16}: 16) = \_\_\_\_\_**

### 16.6.3 Shkencat e tjera shoqërore

(Psikologji; sociologji; filozofi; logjikë; ekonomi; gjeografi në shkollën e mesme të ulët; lëndë me zgjedhje nga fushat përkatëse)

Shënim: Teksti shkollor t'i përmbajë njohuritë themelore e kryesore nga lënda mësimore dhe t'i shpjegojë proceset e fenomenet shoqërore duke u mbështetur në teoritë shkencore dhe njohuritë e avancuara nga fusha përkatëse. Teksti shkollor të përputhet me parimet themelore të Kurrikulit të Republikës së Kosovës dhe me qëllimet e lëndës përkatëse, në mënyrë që duke iu shmangur njëanshmërive në paraqitje dhe interpretime, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të përkrahë dhe të nxisë njohjen e drejtë, mirëkuptimin reciprok, tolerancën, komunikimin ndërkulturor, integrimin, promovimin e të drejtave të njeriut, zhvillimin e demokracisë, zhvillimin ekonomik, social e kulturor, zhvillimin e ideve dhe praktikave intelektuale dhe afirmimin e vlerave të qytetërimit njerëzor.

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.6.3.1	Teksti u përshtatet aftësive njohëse, parajnohurive, nevojave dhe interesave të nxënësit/se; pamja dhe paraqitja e tekstit shkollor përputhet me moshën e nxënësve/eve për të cilët është konceptuar ai.					
16.6.3.2	Për sa i përket konceptit didaktik, terminologjisë së përdorur dhe mënyrës si prezantohen/paraqiten çështjet e trajtuara, teksti shkollor është koherent dhe në përputhje të plotë me konceptin e përgjithshëm të Kurrikulit të Republikës së Kosovës dhe qëllimeve të lëndës përkatëse.					
16.6.3.3	Teksti shkollor është strukturuar në përputhje me njohuritë dhe me metodologjinë e lëndës përkatëse, dhe në tekst shihet qartë se çka duhet të mësojë nxënësi/ja, cilat janë objektivat e të nxënësve dhe cilat janë konceptet e reja që duhet të mësohen.					
16.6.3.4	Teksti shkollor kontribuon në zhvillimin e kulturës së mësimi dhe përmban materiale, udhëzime, sugjerime dhe nxitje për mësim të mëtejshëm dhe të pavarur, informata e të dhëna bibliografike për libra dhe burime të tjera plotësuese për thellimin e njohurive dhe të shkathtësive nga lënda përkatëse.					
16.6.3.5	Teksti shkollor nxit interesimin për lëndën mësimore, duke krijuar qëndrim pozitiv ndaj përmbajtjes së lëndës mësimore, por edhe motivon shkathtësitë e mendimit kritik dhe kreativ.					
16.6.3.6	Teksti shkollor zhvillon lidhje të shumëfishta midis koncepteve shkencore e metodologjike në kuadër të lëndës mësimore dhe ndërlidhet me konceptet e lëndëve mësimore të përafërta.					

16.6.3.7	Teksti shkollor mbështetet në teori shkencore dhe parime morale të kuptueshme dhe të pranueshme, zbatimimi i të cilave është në pajtim me shkallën e zhvillimit psikofizik të nxënësit/es dhe nuk e pengon atë.					
16.6.3.8	Teksti shkollor promovon ide, vlera dhe parime morale duke ndihmuar vetëdijesimin për ndryshimet sociale, kulturore, ekonomike dhe mjedisore që ndërlidhen me zhvillimin shkencor dhe teknologjik.					
16.6.3.9	Teksti shkollor mbështet në njohjen dhe studimin e kushteve të përgjithshme të ekzistencës, të zhvillimit të njeriut dhe të shoqërisë njerëzore, të zhvillimit të kulturës së popujve dhe vendeve të ndryshme, të ruajtjes së mjedisit, ekosistemeve dhe biodiversitetit.					
16.6.3.10	Teksti shkollor nxit mendimin logjik, kognitiv, kritik dhe kreativ, zhvillon aftësitë dhe shkathtësitë hulumtuese në fushën e lëndës përkatëse dhe ndihmon zhvillimin e cilësive pozitive të personalitetit.					
16.6.3.11	Teksti shkollor nxit dhe motivon sjellje të dobishme dhe funksionale (individuale dhe kolektive) dhe afirmon frymën e bashkëpunimit, integritetit dhe të gjithëpërfshirjes së faktorëve social.					
16.6.3.12	Teksti shkollor ndihmon të kuptuarit e proceseve zhvillimore në shoqërinë njerëzore, ndarjen e punës shoqërore, ekonominë, stratifikimin dhe mobilitetin social, politikën, kohezionin dhe integritetin social, progresin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.					
16.6.3.13	Teksti shkollor promovon vlerat dhe parimet e demokracisë dhe të sundimit të ligjit dhe mbështet zhvillimin demokratik, pluralist dhe multietnik të shoqërisë kosovare.					
16.6.3.14	Teksti shkollor i kundërvihet diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe paraqitjes negative e jodinjitoze të individëve dhe të grupeve shoqërore duke pasur parasysh gjininë, moshën, orientimin seksual, përkatësinë racore, etnike, fetare, mënyrën e jetesës, gjuhën dhe kulturën, rajonin, përcaktimin politik, origjinën socio-ekonomike dhe vështirësitë në zhvillimin psikik dhe fizik.					
16.6.3.15	Teksti shkollor afirmon njohjen dhe mbështetjen ndaj proceseve integruese evropiane në të gjitha fushat e jetës shoqërore.					
16.6.3.16	Teksti shkollor afirmon njohjen, respektimin dhe hapjen ndaj vlerave të popujve dhe komuniteteve etnike, kombeve dhe kulturave të tjera në Evropë dhe në botë, dhe zhvillon ndjenjën e dashurisë ndaj Republikës së Kosovës si bashkësi e qytetarëve të barabartë, pa marrë parasysh përkatësinë etnike dhe fetare.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.6.3 ({16.6.3.1 – 16.6.3.16} : 16) = \_\_\_\_\_**

## 16.7 Edukata muzikore

**Shënim:** Teksti shkollor i edukatës muzikore duhet të jetë një udhërrëfyes për mësimdhënësin/en e muzikës në realizimin e objektivave të edukimit muzikor në nivele e klasë të ndryshme. Në anën tjetër, teksti për nxënësin/en është një mjet i domosdoshëm për punë individuale dhe grupore në klasë si dhe për punë të pavarur në shtëpi. Teksti i edukatës muzikore duhet të jetë i plotë dhe i përdorshëm dhe të shoqërohet me burime muzikore-artistike përkatëse në shtojcën e veçantë (CD, DVD etj).

Teksti i edukatës muzikore duhet të konceptohet në njësi mësimore të cilat përmbajnë elemente dhe kombinim të veprimtarive kryesore muzikore: interpretim (këngë dhe lojë në instrumente), dëgjim muzike dhe krijimtari muzikore.

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.7.1	Teksti i edukatës muzikore i përshtatet nivelit përkatës shkollor dhe qasjes metodike e didaktike që përcakton kurrikuli i edukatës muzikore për nivelet përkatëse.					
16.7.2	Teksti ofron përmbajtje nga tri veprimtaritë kryesore muzikore: interpretim (këndim dhe lojë në instrument), dëgjim të muzikës dhe krijimtari muzikore me një lidhje dhe renditje logjike e ciklike të këtyre veprimtarive.					
16.7.3	Përmbajtjet muzikore (shembujt për këndim dhe dëgjim të muzikës) i përshtaten nivelit përkatës shkollor dhe aftësisë perceptuese e interpretuese të nxënës/eve të nivelit përkatës.					
16.7.4	Përmbajtjet muzikore po ashtu e respektojnë diversitetin e formacioneve interpretuese (solistike, ansamble, orkestrale), të formave muzikore, të gjinive muzikore (muzikë programore, absolute, vokale-instrumentale, instrumentale).					
16.7.5	Teksti i respekton diversitetin e trashëgimisë muzikore popullore nga gjithë trevat e Kosovës dhe nga gjinitë e ndryshme të krijimtarisë kombëtare: p.sh. këngë, valle, melodi për instrumente popullore nga të gjitha trevat.					
16.7.6	Teksti respekton diversitetin dhe përfshirjen e krijimtarisë botërore muzikore (popullore dhe artistike) nga vende të ndryshme për t'i edukuar nxënësit/et për një koncept multikulturor.					
16.7.7	Radhitja e temave në tekst i përshtatet konceptit të njësisë mësimore nga lënda e edukatës muzikore që paraqiten gjithëherë të kombinuara përmes ciklit (interpretim-dëgjim-krijim).					
16.7.8	Teksti përdor ilustrimet adekuate që lidhen me temën apo përmbajtjen muzikore sidomos në nivelet kur nuk					

	parashihet shumë notacion muzikor.					
16.7.9	Teksti ofron udhëzime të qarta për nxënësit/et dhe mësimdhënësin/en se si të trajtohet dukuria e caktuar muzikore përmes udhëzimeve si: dëgjojmë, këndojmë, bisedojmë, krijojmë etj.					
16.7.10	Teksti merr parasysh nivelin dhe klasën përkatëse për ofrimin e sasisë dhe nivelin e vështirësisë kur prezanton notacionin muzikor. (P.sh. në tekstet e klasës 1-5, notacioni shërben vetëm për t'u përdorur nga mësuesi/ja, për nxënësit/et ofrohet notacion grafik dhe me simbole).					
16.7.11	Teksti përmban ndërlidhje të bollshme në mes përmbajtjeve muzikore dhe arteve tjera: artet pamore, arti letrar, filmi, drama etj.					
16.7.12.	Teksti përmban material muzikor (notacion) të përshtatshëm për interpretim (këngë dhe përmbajtje për luajtje në instrumentet për fëmijë (instrumentari i Orf-it blokflauti etj.) në shkallë të vështirësisë në përputhje me aftësitë riprodhuese e interpretuese muzikore të nxënësve/eve në klasë përkatëse.					
16.7.13.	Teksti përmban orientime të qarta për punë krijuese të pavarur.					
16.7.14.	Teksti përmban këngë të krijuara, tekstet e të cilave janë me vlerë të lartë letrare. Në rast të përdorimit të këngëve të huaja, teksti i shqipëruar ruan vlerat estetike-letrare të poezisë origjinale.					
16.7.15.	Teksti (CD-ja) përmban shembuj muzikorë për dëgjim të cilët i nxisin nxënësit/et të shprehen me lëvizje e të vallëzojnë.					
16.7.16.	Teksti ofron në mënyrë të ndërlidhur dhe sistematike informata themelore mbi instrumentet e ndryshme muzikore, duke i shoqëruar ato me pamjet e instrumentit dhe me shembuj adekuatë për dëgjim të muzikës (CD) për të ilustruar ngjyrën e tingullit të instrumentit të caktuar.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.7 ({16.7.1 – 16.7.16} : 16) = \_\_\_\_\_**

## 16.8 Edukata figurative (arti figurativ)

Shënim: Standardi vijues synon arritshmëri të lartë mësimore në fushën e arteve figurative duke i përmbledhur të gjithë treguesit esencialë për libra cilësorë të kësaj lënde. Këtu, para së gjithash qëllimet shtrohen si kërkesa reale për mësim të natyrës kërkimore-hulumtuese dhe për njohuri të tjera të dukurive ndryshuese në hapësirë dhe kohë, duke përfshirë: perceptimin, stilet, teknikat dhe etapat e tjera zhvillimore sipas didaktikës së lëndës. Natyra specifike e lëndës kërkon rrugë inovative dhe veprim krijues individual të çdo nxënës/e veç e veç, ndonëse diskutimet, përshkrimet dhe debatet e tjera për historinë e lëndës mund të shtrohen edhe në mënyrë të përbashkët duke i shpjeguar paraqitjet e veprave, po edhe konceptet alternative në këtë fushë. Disa tregues këtu aspirojnë metodologji dhe teknika të ndryshme krijuese për librin e suksesshëm, në mënyrë që interesimi dhe përkushtimi i nxënësve/eve më pastaj të sjellë rezultate dhe freski në krijimet dhe aspiratat e tyre të shumta.

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.8.1	Teksti shkollor i edukatës (artit) figurative përmban koncepte didaktike për zhvillimin e njohurive të nxënësve/eve në të gjitha fushat e mësimin figurativ sipas parimeve aktuale të didaktikës së lëndës (kr. Standardin e përgjithshëm 1.1-1.3)					
16.8.2	Në tekst shkollor është ndërtuar një strukturë e qartë e organizimit të njësive tematike duke i prezantuar të gjitha fushat e duhura të artit figurativ në kronologjinë e arritjeve më të reja shkencore dhe duke e respektuar harmoninë më të përshtatshme të shkronjave dhe ilustrimeve për moshën e nxënësve/eve.					
16.8.3	Teksti shkollor ka ilustrime origjinale të nivelit të lartë si dhe përmbledhje me fotografi, riprodhime (të veprave autoriale) dhe tabela të tjera me grafikë përcjellëse gjatë shpjegimeve metodologjike sipas nivelit dhe klasës (p.sh. për nivelin e parë numri dhe mosha e personazheve të ilustruara dallon nga nivelet më të larta).					
16.8.4	Teksti shkollor sjell përmbajtje të qëndrueshme shkencore, me radhitje të përshtatur të njësive mësimore, sipas logjikës më të lehtë të të kuptuarit dhe me shembuj, ushtrime dhe formulime të tjera praktike, që kontribuojnë në ndërtimin sistematik të njohurive të përgjithshme dhe të arritjeve krijuese.					
16.8.5	Përshtatja dhe mënyra e prezantimit të njësive tematike dhe ilustrimeve grafike në tekst shkollor inkurajojnë nxënësit/et për vetëbesim kërkues në situata dhe përgjegjësi hulumtuese duke i motivuar ata për sfida dhe suksese promovuese në disiplinat e adhuruara të kësaj lënde.					



16.8.6	Teksti shkollor përmban materiale kuptimplote, të specifikuar në mënyrë të përshtatshme vizuale dhe vep-ruese, për t'i motivuar nxënësit/et në bashkëveprim, komunikim dhe mundësim të përvetësimit dhe transferimit të njohurive të njëri-tjetri.					
16.8.7	Teksti shkollor është në përputhje me normat e gjuhës letrare-figurative, i përshtatur për moshën dhe aftësitë psikofizike të nxënësve/eve dhe gjithnjë i pasuruar me detaje të përshkrimeve dhe të udhëzimeve të tjera tekniko-kreative.					
16.8.8	Realiteti shoqëror, historik dhe kulturor i Kosovës pasqyrohet në formë plurale, duke promovuar nxitjen e tolerancës dhe të kompetencave të tjera ndërkulturore me shembuj konkretë të riprodhimeve të veprave autoriale dhe të ilustrimeve të tjera në tekst shkollor.					
16.8.9	Teksti shkollor i edukatës (artit) figurative kontribuon në mënyrë kërkimore në formimin e personalitetit krijues të nxënësve/eve në bazë të kreativitetit individual, të njohurive (për teknikën, stilet etj.) si dhe të aspekteve të tjera pedagogjike.					
16.8.10	Teksti shkollor i orienton nxënësit/et në edukimin e tyre tolerant përmes rrugës së kërkimeve artistike, dialogëve të ndërsjellë për historianë dhe risitë e veçanta të kësaj fushe dhe metodologjinë bashkëkohore në kooperimin e përvojave individuale.					
16.8.11	Teksti shkollor figurativ gjeneron qasje të baraspeshuara në përmbajtje, shembuj dhe ilustrime të tjera, duke iu shmangur diskriminimit gjinor edhe në aspektin e përfaqësimit të autorëve me veprat e prezantuara.					
16.8.12	Teksti shkollor përmban qasje me ide kërkimore, rubrika me punime praktike, udhëzime vepruese me pyetje koncize dhe detyra tërheqëse, që nxënësit/et të mund të vazhdojnë plotësimin e tyre në mënyrë të pavarur dhe me siguri të plotë.					
16.8.13	Në brendinë e vet apo si pjesë e veçantë me materiale pune, teksti shkollor udhëzon, nxit dhe kompletton përvetësimin më të lehtë të njësive tematike, duke e ngritur motivimin e shumëllojshëm për krijime figurative.					
16.8.14	Në tekstin shkollor paraqiten forma, teknika dhe stile të punës praktike të cilat sqarojnë në detaje fazat kërkimore-hulumtuese dhe mundësitë e llojlojta realizuese.					
16.8.15	Teksti shkollor i edukatës (artit) figurative si projekt i kompletuar mësimor përmban edhe informata të tjera shtesë për zhvillimin e artit virtual përmes ëeb faqeve, linkeve elektronike apo CD-ve e DVD-ve.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.8 ({16.8.1 – 16.8.15} : ) = \_\_\_\_\_**

## 16.9 Punë dore (vetëm klasat 1 – 5)

Shënim: Tekstet shkollore për lëndën *Punë dore* duhet të jenë bashkëkohore për nga lënda që trajtojnë, metodologjia e shtjellimit si dhe qasja didaktike dhe pedagogjike. Ato duhet të përmbajnë materiale, të dhëna dhe metoda të reja pune që do të ju ndihmojnë nxënësve/eve dhe mësuesve/eve në përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme për integrim në proceset globale ku përparimet teknologjike janë shtysë e rëndësishme e zhvillimit shoqëror në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik në veçanti.

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.9.1	Përmbajtjet në tekst janë aktuale, me relevancë, të bazuara në arritjet më të reja në shkencat natyrore, veçanërisht në ato teknike dhe informatike.					
16.9.2	Idetë, konceptet, eksperimentet, shembujt dhe projektet e punimeve të dorës në tekstin shkollor janë bërë në mënyrë dhe nivel të kapshëm, të kuptueshëm, për grup moshën e nxënësve/eve.					
16.9.3	Lënda e paraqitur në tekst, veçanërisht punimet praktike, nxisin dhe zhvillojnë kreativitetin individual dhe njëkohësisht aftësinë dhe afinitetin për punë ekipore të nxënësve/eve.					
16.9.4	Lënda e shtjelluar në tekstin shkollor është në harmoni me karakteristikat zhvillimore të moshës së nxënësve/eve dhe është e renditur sipas shkallës së vështirësisë, duke filluar nga më të thjeshtat.					
16.9.5	Projektet e punës së dorës si dhe eksperimentet dhe ushtrimet janë të koncipuara dhe strukturuara ashtu që të zhvillojnë aftësinë e nxënësve/eve për zbatimin e dijenive të mësuara në praktikë.					
16.9.6	Përmes ngritjes graduale të shkallëve të kompleksitetit të punëve të dorës, të parashtruara në tekstin shkollor, nxënësi/ja kultivon ndjenjën e efikasitetit të punës, racionalizimit dhe sidomos të vetëbesimit për arritje gjithnjë më të avancuara vetanake.					
16.9.7	Ilustrimet janë të shumta, të sakta dhe të kuptueshme, me veçori të theksuara të logjikës teknike. Aty ku është e nevojshme ilustrimet kanë legjenda shpjeguese të kuptueshme dhe të dallueshme (me numra, shkronja apo ngjyra të ndryshme).					
16.9.8	Në tekstin shkollor i është kushtuar kujdes i duhur emërtimeve tekniko-teknologjike bashkëkohore, duke e ruajtur një baraspeshë të ndjeshme në mes të përdorimit të emërtimeve dhe shkurtesave teknike në gjuhën origjinale dhe të përkthimit të tyre në gjuhën shqipe.					

16.9.9	Teksti shkollor përmban teste për vetëvlerësim që janë gjithëpërfshirës, të kuptueshëm dhe praktik për përdorim dhe njëkohësisht tërheqës për nxënësit.					
16.9.10	Në tekstin shkollor i është kushtuar kujdes i veçantë aspekteve të edukimit shëndetësor.					
16.9.11	Ushtrimet dhe punimet praktike janë të koncipura ashtu që zhvillojnë ndjenjën e nxënësve/eve për kursim të materialeve që përdoren për të realizuar ato.					
16.9.12	Në tekstin shkollor i është kushtuar vëmendje e veçantë kujdesit ndaj mjedisit duke trajtuar në mënyrë sistematike, të bazuar në shkencë dhe në mënyrë dhe nivel të kuptueshëm për nxënësit/et, varësinë shkak-pasojë të aktiviteteve të njeriut (në ekonomi, industri, energjetikë, etj.) në ndotjen lokale dhe globale të mjedisit.					
16.9.13	Teksti shkollor është në përputhje të plotë dhe koherent me tekstet e të gjitha klasave tjera të lëndës <i>Punë dore</i> në aspektin e përdorimit të simboleve (shenjat e komunikacionit, elementet e vizatimit teknik, etj.), shkurtesave dhe emërtimeve teknike.					
16.9.14	Faqosja dhe dizajni i përgjithshëm i tekstit është në nivel të lartë teknik dhe estetik. Janë përfillur në masën më të madhe të mundshme standardet teknike të dizajnit grafik, të faqosjes dhe të cilësisë estetike.					
16.9.15	Përveç kërkesave nga standardi themelor, doracaku për mësimdhënës/e i lëndës <i>Punë dore</i> përfshin udhëzime për organizimin e punëve të dorës në punishte të shkollës ose në klasë, të ushtrimeve në poligonin shkollor për kulturën e komunikacionit dhe kultivimin e ambientit shkollor, si dhe për organizimin e vizitave fabrikave, punëtorive prodhuese, prodhuesve agrikuturalë, stacionit të autobusëve, aeroportit, stacionit të zjarrfikësve, FSK -së, etj. sipas lëndës që shtjellohet në tekstin shkollor.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.9 ({16.9.1 – 16.9.15} : 15) = \_\_\_\_\_**

## 16.10 Teknologji me informatikë (TIK)

Shënim: Tekstet shkollore nga lëmi i teknologjisë luajnë rolin e mediumit, mjetit ndihmës dhe kontribuojnë në zhvillimin e njohurive, kompetencave dhe të aftësive të nxënësve/eve në aspekte të ndryshme të studimit të profesionit të teknologjisë. Ato u ndihmojnë nxënësve/eve për të çmuar me realizëm vlerat dhe potencialin e tyre, për t'u orientuar drejt në drejtime të karrierës profesionale të ardhshme dhe për të marrë përgjegjësi në procesin e zhvillimit të tyre të vazhdueshëm personal dhe profesional; mbështesin nxënësit/et për të zhvilluar format e bashkëpunimit dhe të besimit të ndërsjellë nëpërmjet përvojës së punës praktike; janë burim i njohurive për zhvillimet e perspektivave të profesionit të tyre, të para këto në kontekstet e integritit rajonal dhe evropian. Teksti shkollor i teknologjisë përmban njohuritë dhe proceset më të reja teknologjike në sektorin e profesionit përkatës. Teksti shkollor i teknologjisë përmban rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së ambientit, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Tekstet shkollore u ndihmojnë nxënësve/eve në punë të pavarur teoretike, eksperimentale dhe praktike, në zhvillimin e shkathtësive dhe të shprehive të përhershme, për të matur, përpunimin e të dhënave, zbatimin e tyre në situata konkrete, të menduarit kritik dhe kreativ, aftësimin për të përdorur literaturë dhe burime të tjera për nxënie. Këtij qëllimi i shërbejnë udhëzimet në lidhje me strategjitë e të mësuarit, përgatitja, përpilimi dhe paraqitja e lëndës mësimore në atë mënyrë e cila e mbështet të mësuarit në mënyrë vepruese, aktive dhe motivuese.

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.10.1	Ndërtimi dhe struktura didaktike e tekstit shkollor të teknologjisë është e qartë, e kapshme dhe ofron orientim të lehtë dhe zbatim praktik të lëndës së trajtuar gjatë mësimit.					
16.10.2	Format, mënyrat dhe ecuritë e paraqitjes së ligjshmërive që prezantohen në tekstin shkollor të teknologjisë janë të thjeshta, të sakta dhe koherente.					
16.10.3	Teksti shkollor i teknologjisë në mënyrë efektive i referohet arritjeve më të reja tekniko-teknologjike nga lëmi i profesionit përkatës.					
16.10.4	Kuptimi i ligjshmërive në tekstin shkollor të teknologjisë, bazohet në arritjet e reja shkencore tekniko-teknologjike, hulumtimet në laboratorë, industri të prodhimit, institucione hulumtuese, firma ushtrimore,					

	qendra hulumtuese-informatike, trajnuese, të cilat e motivojnë nxënësin/en për të hulumtuar dhe për të arritur të reja shkencore.					
16.10.5	Teksti shkollor i teknologjisë ofron materiale, sugjerime, prova, ushtrime, detyra, eksperimente për secilin nivel të të mësuarit: njohje – kuptim – zbatim – mendim kritik ( analizë, sintezë, vlerësim).					
16.10.6	Përmbajtja dhe objektivat e tekstit të teknologjisë janë në koherencë me ato të lëndëve të tjera (të shkencave matematiko-natyrore, të shkencave shoqërore apo të lëndëve të tjera profesionale), për të realizuar një integrim ndërëndor të balancuar, por edhe për të shmangur paralelizmat (përsëritjet) ose zbrazëtitë.					
16.10.7	Realizimi i objektivave të përgjithshme të programit në tekstin shkollor të teknologjisë, për secilin nivel të të mësuarit: njohje, kuptim, zbatim, mendim kritik (analizë, sintezë, vlerësim), kontrollohet në fund të çdo tërësie programore (moduli) me kërkesa të parashtruara që u bëhen nxënës/eve.					
16.10.8	Detyrat, provat, demonstrimet, eksperimentet, matjet e thjeshta, vëzhgimet në tekstin shkollor të teknologjisë u referohen, vazhdimisht dhe me kuptim, zhvillimit të shkathësive dhe kompetencave në pajtim me zhvillimin tekniko-teknologjik dhe mundëson integrimin e nxënësve/eve në tregun e punës.					
16.10.9	Teksti shkollor i teknologjisë u ofron nxënësve/eve probleme, metoda aplikative (matematikore, kimike, fizike etj.), zgjidhje interesante, tërheqëse, por edhe mundësi dhe sugjerime të ndryshme për të mësuarit në mënyrë hulumtuese dhe të pavarur.					
16.10.10	Përmes materialeve, sugjerimeve, ushtrimeve, detyrave, provave, demonstrimeve dhe eksperimenteve të përshtatshme, teksti shkollor i teknologjisë ofron zhvillimin e aftësive njohëse, emocionale, psikomotorike dhe të kompetencave profesionale praktike të nxënës/eve.					
16.10.11	Në tekstin shkollor të teknologjisë paraqitën ecuri të ndryshme deri te i njëjti përfitim, paraqiten përfitime nga arritjet me anë të provave eksperimentale, demonstrimeve, vrojtimeve dhe zgjidhjeve të detyrave me ecuri të ndryshme që nxisin strategji vetjake të të mësuarit dhe të të hulumtuarit.					
16.10.12	Teksti shkollor i teknologjisë përmes rezultateve eksperimentale, vëzhgimeve në terren, laborator ose punishte dhe detyrave tipike nxënës/eve ua ofron mundësinë e të mësuarit në mënyrë ekipore ose të pavarur në përputhje me moshën e tyre.					
16.10.13	Teksti shkollor i teknologjisë përmban udhëzime për kryerjen e punëve eksperimentale që janë motivuese për nxënësin/en për të zbatuar njohuritë e fituara në punën profesionale.					
16.10.14	Detyrat, sugjerimet për punë të mëtejshme, ushtrimet, provat, demonstrimet dhe eksperimentet në tekstin					

	shkollor të teknologjisë janë përpiluar ashtu që ta nxitin motivimin, komunikimin dhe ndërveprimin e nxënës/eve (projekte).					
16.10.15	Teksti shkollor i teknologjisë është i përshtatshëm për diferencimin e brendshëm të nxënës/eve dhe për mësimin individualizues, sepse ofron, detyra, ushtrime, prova, demonstrime, eksperimente dhe vëzhgime të niveleve të ndryshme, sipas vështirësisë dhe kërkesave.					
16.10.16	Teksti shkollor i teknologjisë u ofron nxënës/eve teknika dhe mënyra për vetëvlerësim.					
16.10.17	Përmbajtja e njësive mësimore në tekstin e teknologjisë është e baraspeshuar në përputhje me aftësitë psikologjike dhe njohëse të nxënës/eve.					
16.10.18	Në tekstin shkollor paraqiten rregullat e edukimit shëndetësor dhe të ruajtjes së mjedisit jetësor.					
16.10.19	Në fund të tekstit shkollor të teknologjisë gjendet një fjalor përmbledhës i termave dhe koncepteve kryesore të trajtuara, si dhe një indeks i termave profesionalë.					
16.10.20	Në tekstin shkollor të teknologjisë paraqiten rregullat e sigurimit teknik: gjatë kryerjes së provave eksperimentale në laboratorë, industri prodhimi duke iu përmbajtur referencave për materiale të rrezikshme nga aspekti i mbrojtjes së shëndetit (varësisht nga profili profesional)					
16.10.21	Në tekstin shkollor të teknologjisë shënimi i simboleve dhe formulave, si dhe emërtimi i tyre është në përputhje me sistemin ndërkombëtar ISO (të njësive «sistemi SI»; IEC 60027; standardeve ndërkombëtare dhe standardeve të reja (aktuale) të profesionit, rregullave të IUPAC-ut etj.					
16.10.22	Në tekstin shkollor të teknologjisë paraqiten kërkesat për cilësinë e prodhimeve sipas standardeve aktuale, si ato ushqimore me marrëveshjen HACCP, dhe në hap me standardet e reja.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.10 ({16.10.1 – 16.10.22} : 22 ) = \_\_\_\_\_**

## 16.11 Edukata fizike dhe sportive

Shënim: Teksti shkollor i edukatës fizike dhe sportive ka vlerë dhe rëndësi të posaçme për zhvillimin dhe përvetësimin e diturive, shkathtësive dhe shprehive motorike si dhe për transformimin e aftësive psiko-fizike të nxënësit/es. I ndihmon mësimdhënësit/et që procesin mësimor ta organizojnë sipas kërkesave bashkëkohore (shkencore dhe profesionale).

Synimi kryesor i tekstit të edukatës fizike dhe sportive është që të arrihen qëllimi dhe objektivat e lëndës duke mundësuar që nxënësi/ja të arrijë:

- zhvillimin trupor, zhvillimin e aftësive lëvizore dhe funksionale,
- përvetësimin dhe përforsimin e njohurive të ndryshme motorike,
- njohjen me njohuritë teorike dhe
- përjetimin e këndshëm të edukimit fizik dhe sportiv, formimin e qëndrimit të drejtë.

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.11.1	Sendërtimi, struktura e përmbajtjes, skenimi i simboleve, ilustrimi dhe emërtimi, në tekstin shkollor të edukatës fizike dhe sportive, është sipas kërkesave didaktike dhe metodike të lëndës.					
16.11.2	Forma, ecuria dhe mënyra e paraqitjes së detyrave motorike (njësive mësimore) në tekstin shkollor është në përputhje me ligjet shkencore dhe profesionale të karakteristikave antropologjike të nxënësit/es.					
16.11.3	Teksti shkollor i edukatës fizike dhe sportive është i përgatitur dhe i hartuar si për mësimin e përgjithshëm edhe për mësimin zgjedhor që nxënësi/ja do ta zgjedhë.					
16.11.4	Tematikat mësimore si dhe njësitë mësimore (nga tematikat), në tekstin shkollor janë të përfshira dhe të përgatitura metodikisht (të ilustruara, teknika e të ekzekutuarit, metoda e të përvetësuarit, mënyra e demonstrimit) që nxënësi/ja ka mundësi më shpejt, më lehtë dhe më drejtë t'i përvetësojë detyrat motorike-lëvizore si gjatë organizimit të procesit të rregullt mësimor në orë, ashtu edhe në mënyrë të pavarur, d.m.th. jashtë procesit mësimor.					
16.11.5	Teksti shkollor i edukatës fizike dhe sportive, nxënësit/es i mundëson që të begatohet me nocione					

	(terminologji), sipas rregullave dhe kërkesës së gjuhës shqipe e që shfrytëzohen në lëndën e edukatës fizike dhe sportive, të jetë më kreativ dhe atraktiv gjatë aktiviteteve të ndryshme sportive.					
15.11.6	Ushtrimet e formimit si dhe përmbajtjet e tjera programore të paraqitura në tekstin shkollor të edukatës fizike dhe sportive ndikojnë në zhvillimin e aftësive motorike të nxënësit/es (forcë, shpejtësi, qëndrueshmëri, shkathtësi, lëvizshmëri etj.).					
16.11.7	Ushtrimet e formimit të paraqitura në tekst, përveç terminologjisë adekuate, janë edhe të ilustruara kështu që për nxënësin/en janë më të kapshme që më lehtë, më shpejt dhe më drejtë t'i ushtrojnë edhe jashtë mësimit të rregullt si dhe në edukimin e shprehive lëvizore.					
16.11.8	Në tekstin shkollor të edukatës fizike janë të cekura edhe devijimet trupore (kifoza, lordoza, skolioza, shputat e këmbëve të rrafshëta, këmbët X dhe O), si dhe ushtrimet trupore, të cilat, nxënësit/et me devijim përkatës i mundësohet që ushtrimet t'i shfrytëzojë (ushtrojë) në mënyrë të pavarur duke ndikuar në përmirësimin e të mbajturit të drejtë të trupit.					
16.11.9	Përveç aftësisimit nga aspekti i diturive dhe i arritjeve motorike, teksti shkollor i mundëson nxënësit/es të fitojë dituri mbi formimin dhe zhvillimin e jetës sportive, të përjetojë kënaqësi gjatë garave dhe gjatë jetës. Të socializohet si në kuadër të shkollës, ashtu edhe jashtë – në mjedisin shoqëror.					
16.11.10	Me shfrytëzimin e tekstit shkollor të edukatës fizike dhe sportive, nxënësi/ja do të aftësohet edhe për organizimin e ushtrimeve me nxënës/e të tjerë, ose më të interesuarit nga mjedisi shoqëror.					
16.11.11	Literatura e shfrytëzuar për hartimin dhe përgatitjen e tekstit të edukatës fizike dhe sportive është e bazuar plotësisht në kërkesat shkencore dhe profesionale për tekst shkollor të kësaj lënde.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.11 ({16.11.1 – 16.11.11 } : 11 ) = \_\_\_\_\_**



## 16.12 Materiale didaktike për nivelin parashkollor

Fushat e aktiviteteve: *Edukimi fizik dhe shëndeti, Gjuha amtare, Edukimi artistik (edukimi muzikor dhe edukimi figurativ), Matematika dhe Njohja e vetes dhe e botës.*

Shënim: Materialet didaktike për nivelin parashkollor duhet të nxisin bashkëveprim të përshtatshëm edukator – fëmijë – prind, si një trinom i pandarë në formimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përmbajtjet e materialeve didaktike parashkollore duhet të ofrojnë sa më shumë mundësi për tërësinë e aftësive, njohurive, vlerave, shprehive dhe sjelljeve që duhet t'i fitojë fëmija në kopsht. Materialet të ofrojnë mundësi që t'i rriten përgjegjësitë e edukatores në punën me fëmijë, të ndihmojnë dhe të inkurajojnë fëmijët për të qenë bashkëveprues aktivë në punën edukative institucionale dhe të sigurojnë rritjen progresive të cilësisë së veprimtarisë edukative. Materialet didaktike duhet t'i ndihmojnë fëmijët t'i ndërtojnë dhe t'i zhvillojnë njohuritë e veta dhe të përgatiten për përvetësimin e njohurive të strukturuar të shkollës fillore. Hartuesit e materialeve parashkollore didaktike duhet të kenë parasysh se fëmija është bartës i potencialeve të pakufishme, se vitet e para të jetës janë të rëndësishme, madje përcaktuese për të ardhmen e çdo individi dhe se ndërveprimi mjedisor mund të favorizojë apo të frenojë zhvillimin e potencialeve të fëmijëve.

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.12.1	Materiali parashkollor didaktik është në përputhje me filozofinë, parimet, qëllimet, integrimin ndërfaqor, objektivat e përgjithshëm dhe të veçantë të fushave të aktiviteteve të Kurrikulit të edukimit parashkollor të Kosovës.					
16.12.2	Përmbajtja, struktura dhe koncepti didaktik i materialit parashkollor është në funksion të edukimit sistematik të aspekteve të ndryshme të personalitetit dhe të aftësive kognitive, gjuhësore, krijuese etj. të fëmijës.					
16.12.3	Materiali është i kuptueshëm, i kohës, i saktë dhe i përshtatshëm me moshën psikofizike të fëmijës.					
16.12.4	Përmbajtja në materialin e nxit aktivitetin njohës dhe zhvillimin e aftësive të fëmijëve për të kuptuar fjalë të reja, fakte, nocione, rregulla, etj., nxit të menduarit dhe përjetimin emocional në temat që lidhen me familjen, jetën dhe vlerat kulturore.					
16.12.5	Materiali parashkollor është në pajtim me nevojat dhe aftësitë e fëmijëve parashkollore, i afërt me jetën, mbështetet në realitetin jetësor dhe është në fushën e interesimeve të fëmijëve.					
16.12.6	Aparatura didaktike, pyetjet dhe detyrat kanë përmbajtje që zhvillon vlera dhe qëndrime personale të fëmijëve, ofrojnë shembuj për respektimin e të drejtave të fëmi-					

	jës/njeriut, për tolerancë, barazi gjinore dhe kultivon edukimin ndërkulturor.					
16.12.7	Përmbajtjet e materialit – temat, ilustrimet dhe fotografitë e zgjedhura ofrojnë mundësi që fëmijët të njohin vetveten, rrethin ku jetojnë e vepronë dhe botën.					
16.12.8	Materiali nxit dhe promovon mjaftueshëm punën e pavarur të fëmijës.					
16.12.9	Ilustrimet, temat, detyrat dhe ushtrimet e materialit parashkollor janë në harmoni me karakteristikat zhvillimore të moshës së fëmijëve parashkollorë dhe janë të renditura sipas shkallëve të ndryshme të vështirësisë, duke filluar nga më të thjeshtat.					
16.12.10	Përmbajtjet e zgjedhura në materialin parashkollor reflektojnë në zhvillimin e vetëbesimit të fëmijës për mundësitë e tij krijuese, nxisin interesimin e fëmijës për vëzhgim e krahasim, si dhe për të menduarit e pavarur logjik.					
16.12.11	Materiali përforcon lloje të të mësuarit aktiv: hap pas hapi, mendim kritik, zgjidhje të problemave etj. të kërkuara nga sistemi i edukimit parashkollor, nxit fëmijët për bashkëpunim dhe punë në grupe.					
16.12.12	Materiali parashkollor paraqet metoda dhe forma pune interesante dhe tërheqëse për fëmijët, ku fëmija vëzhgon, krahason dhe klasifikon objektet sipas karakteristikave: masës, formës, ngjyrës, temperaturës, ndjesisë etj.					
16.12.13	Materiali parashkollor ka elemente të mjaftueshme, gjithëpërfshirëse që fëmijën parashkollor ta përgatisë për klasë të parë të shkollës fillore.					
16.12.14	Materiali parashkollor shoqërohet, nëse është me kuptim, me mjete ndihmëse si CD, me qëllim që fëmijët të zhvillojnë më lehtë shkathtësitë e komunikimit, imagjinatën dhe kreativitetin.					
16.12.15	Materiali është i shoqëruar me udhëzues përkatës didaktik-praktik për edukatorë/e dhe prindër.					
16.12.16	Udhëzimet që e shoqërojnë materialin kanë karakter motivues për biseda dhe komunikim të hapur, me qëllim të përkrahjes së zhvillimit gjuhësor të fëmijëve dhe edukimit të aspekteve të ndryshme të personalitetit të fëmijës.					
16.12.17	Materiali parashkollor dhe udhëzuesi përkatës i rrisin përgjegjësitë e edukatores për punë me fëmijë, i ndihmojnë e inkurajojnë fëmijët për të qenë bashkëveprues aktivë: edukator/e – fëmijë – prind.					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.12 ({16.12.1 – 16.12.17} : 17) = \_\_\_\_\_**

## 16.13 Tekste shkollore për profesione të ndryshme në shkollat profesionale

**Shënim:** Tekstet shkollore nga lëmi i arsimit profesional luajnë rolin e mediumit, mjetit ndihmës dhe kontribuojnë në zhvillimin e njohurive, kompetencave dhe të aftësive të nxënësve/eve në aspekte të ndryshme të studimit të profesionit. Ato u ndihmojnë nxënësve për të çmuar me realizëm vlerat dhe potencialin e tyre, për t'u orientuar drejt në drejtimet e karrierës profesionale të ardhshme dhe për të marrë përgjegjësi në procesin e zhvillimit të tyre të vazhdueshëm personal dhe profesional; mbështesin nxënësit për të zhvilluar format e bashkëpunimit dhe të besimit të ndërsjellë nëpërmjet përvojës së punës praktike; janë burim i njohurive për zhvillimet perspektive të profesionit të tyre, të para këto në kontekstet e integritit rajonal dhe evropian.

Teksti shkollor i arsimit profesional përmban njohuritë dhe proceset më të reja teknologjike në sektorin e profesionit përkatës. Teksti shkollor i arsimit profesional përmban rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Tekstet shkollore u ndihmojnë nxënësve/eve në punë të pavarur teorike, eksperimentale dhe praktike, në zhvillimin e shkathtësive dhe të shprehive për të matur, për përpunimin e të dhënave, për zbatimin e tyre në situata konkrete, të menduarit kritik dhe kreativ, aftësimin për të përdorur literaturë dhe burime të tjera për nxënie. Këtij qëllimi i shërbejnë udhëzimet në lidhje me strategjitë e të mësuarit, përgatitja, përpilimi dhe paraqitja e lëndës mësimore në atë mënyrë e cila e mbështet të mësuarit në mënyrë vepruese, aktive dhe motivuese

Nr.	<b>Tregues</b> (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.13.1	Ndërtimi dhe struktura didaktike e tekstit shkollor të arsimit profesional të jetë e qartë, e kapshme dhe të ofrojë orientim të lehtë dhe zbatim praktik të lëndës së trajtuar gjatë mësimit.					
16.13.2	Format, mënyrat dhe ecuritë e paraqitjes së ligjshmërive që prezantohen në tekstin shkollor të arsimit profesional janë të thjeshta, të sakta dhe koherente.					
16.13.3	Teksti shkollor i arsimit profesional, në mënyrë efektive i referohet arritjeve më të reja teknologjike nga lëmi i profesionit përkatës.					
16.13.4	Kuptimi i ligjshmërive në tekstin shkollor të arsimit profesional, përfitimi i formulave kimike, teknologjike i formulave fizike, kuptimi i veprimeve matematikore, matematikës aplikative, analizave numerike, ndërtohet dhe zhvillohet hap pas hapi pa kapërcime, në mënyrë të kujdesshme dhe jo imponuese me qëllim që					

	nxënësit/et të jenë sa më shumë aktivë/e dhe të mund të veprojnë në mënyrë të pavarur.					
16.13.5	Teksti shkollor i arsimit profesional ofron materiale, sugjerime, prova, ushtrime, detyra, eksperimente për secilin nivel të të mësuarit: njohje – kuptim – zbatim – mendim kritik ( analizë, sintezë, vlerësim).					
16.13.6	Objektivat e lëndës (që pasqyrohen në tekstin shkollor përkatës) janë në koherencë me qëllimet dhe synimet e shkollimit në profiling dhe nivelin të cilit i dedikohet teksti shkollor.					
16.13.7	Përmbajtja dhe objektivat e tekstit të lëndëve profesionale janë në koherencë me ato të lëndëve të tjera (të shkencave matematiko-natyrore, të shkencave shoqërore apo të lëndëve të tjera profesionale), për të realizuar një integrim ndërlëndor të balancuar por edhe për të shmangur paralelizmat (përsëritjet) ose zbrazëtitë.					
16.13.8	Realizimi i objektivave të përgjithshëm të programit në tekstin shkollor të arsimit profesional, për secilin nivel të të mësuarit: njohje, kuptim, zbatim, mendim kritik (analizë, sintezë, vlerësim), kontrollohet në fund të çdo tërësie programore (moduli) me kërkesa të parashtruara që u bëhen nxënësve/eve.					
16.13.9	Detyrat, provat, demonstrimet, eksperimentet, matjet e thjeshta, vëzhgimet në tekstin shkollor të arsimit profesional u referohen, vazhdimisht dhe me kuptim, zhvillimit të shkathtësive dhe kompetencave në pajtim me zhvillimin teknologjik dhe mundëson integrimin e nxënësve/eve në tregun e punës.					
16.13.10	Teksti shkollor i arsimit profesional u ofron nxënësve/eve zgjidhjen e problemeve, metoda aplikative (matematikore, kimike, fizike etj.), zgjidhje interesante, tërheqëse, por edhe mundësi dhe sugjerime të ndryshme për të mësuarit në mënyrë hulumtuese dhe të pavarur.					
16.13.11	Përmes materialeve, sugjerimeve, ushtrimeve, detyrave, provave, demonstrimeve dhe eksperimenteve të përshtatshme, teksti shkollor i arsimit profesional ofron zhvillimin e aftësive njohëse, emocionale, psikomotorike dhe të kompetencave profesionale praktike të nxënësve/eve.					
16.13.12	Në tekstin shkollor të arsimit profesional paraqitën ecuri të ndryshme deri te i njëjti përfundim, paraqiten përfundime të nxjerra nga provat, demonstrimet, matjet eksperimentale dhe vëzhgimeve (në natyrë ose laborator) dhe zgjidhje të detyrave me ecuri të ndryshme, që nxisin strategji vetjake të të mësuarit.					
16.13.13	Teksti shkollor i arsimit profesional përmes demonstrimeve, eksperimenteve, matjeve, vëzhgimeve në terren, laborator ose punishte dhe detyrave tipike nxënësve/eve ua ofron mundësinë e të mësuarit në mënyrë ekipore ose të pavarur në përputhje me moshën e tyre.					
16.13.14	Teksti shkollor i arsimit profesional përmban sasi të					

	mjaftueshme të ushtrimeve, detyrave, provave, demonstrimeve, eksperimenteve që janë motivuese dhe mundësojnë thellimin dhe zbatimin e njohurive të fituara në jetën profesionale.					
16.13.15	Detyrat, sugjerimet për punë të mëtejshme, ushtrimet, provat, demonstrimet dhe eksperimentet në tekstin shkollor të arsimit profesional janë përpiluar, ashtu që ta nxitin motivimin, komunikimin dhe ndërveprimin e nxënësve/eve (projekte).					
16.13.16	Teksti shkollor i arsimit profesional është i përshtatshëm për diferencimin e brendshëm të nxënësve/eve dhe për mësimin individualizues, sepse ofron, detyra, ushtrime, prova, demonstrime, eksperimente dhe vëzhgime të niveleve të ndryshme, sipas vështirësisë dhe kërkesave.					
16.13.17	Teksti shkollor i arsimit profesional u ofron nxënësve/eve teknika dhe mënyra për vetëvlerësim.					
16.13.18	Ngarkesat (vëllimi) e njësive mësimore në tekstin shkollor të arsimit profesional janë të baraspeshuara në mes vetes, në përputhje me lëndën mësimore dhe aftësitë psikologjike dhe kognitive të nxënësve/eve.					
16.13.19	Në tekstin shkollor paraqiten rregullat e edukimit shëndetësor dhe të ruajtjes së mjedisit jetësor.					
16.13.20	Në fund të tekstit shkollor të arsimit profesional është fjalori përmbledhës i termave dhe koncepteve kryesore të trajtuara, si dhe indeksi i termave profesionalë.					
16.13.21	Në tekstin shkollor të arsimit profesional paraqiten rregullat e sigurimit teknik gjatë provave, proceseve teknike-teknologjike, demonstrimeve, eksperimenteve dhe vëzhgimeve, si dhe lista e materialeve të rrezikshme bashkë me listën e rreziqeve në punë (varësisht nga profili profesional)					
16.13.22	Në tekstin shkollor të arsimit profesional shënimet i simboleve dhe formulave, si dhe emërtimi i tyre është në përputhje me sistemin ndërkombëtar ISO (të njësive «sistemi SI»; IEC 60027; standardeve ndërkombëtare dhe standardeve të profesionit, rregullave të IUPAC-ut, etj.).					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16 ({16.13.1 – 16.13.22 } : 22) =**

## 16.14 Tekste shkollore për diasporën

Shënim: Heterogjeniteti dhe larmia në plan të gjetjes së modeleve më prem-tuese të organizimit të mësimit plotësues në gjuhën amtare (MPGJA) (sipas shteteve, njësive brenda shteteve dhe bartësve tjerë të organizimit), puna dhe kërkesat e kurrikulës së tipit të integruar, prezenca e moshave të ndryshme kryesisht në klasa të bashkuara (të kombinuara), interesat tjera të nxënësve/eve, të prindërve dhe të shoqërisë, ndryshueshmëria e kompetencave paraprake të nxënësve/eve në fusha të caktuara, baza profesionale-kualifikuese e mësueseve dhe e mësues/eve (zakonisht jo mjaftueshëm kompatible me qëllimet dhe objektivat e Kurrikulës ....) dhe faktorë të tjerë, janë faktorë që duhen marrë në konsiderim gjatë përcaktimit të standardeve specifike për tekstet shkollore për diasporën. Vetë natyra e punës dhe kërkesat e kurrikulës së integruar kërkojnë edhe tekste të tipit të integruar (tekste ndërkurrikulare). Një pjesë e mirë e treguesve të zberthyer në standardet e përgjithshme dhe në ato për lëndët: gjuhë amtare (përfshirë abetaren, librin e leximit me librin e gjuhës), histori, gjeografi, edukatë muzikore, edukatë figurative vlejné edhe për tekstet shkollore për MPGJA në diasporë. Gjithnjë teksti shkollor për SHMPGJA është në funksion të realizimit të tri qëllimeve themelore, të njohura tashmë si

- ruajtje dhe zhvillim i identitetit kombëtar,
- integrim në shoqërinë vendore dhe
- integrim apo riintegrim më i lehtë në shoqërinë e origjinës.

Varësisht prej gjuhës së vendit dhe marrëdhënieve të saj me gjuhën shqipe dhe elementet e tjera identitare, hartohet abetare e veçantë ose plotësor abetareje, e cila me qëllim të alfabetizimit sa më efikas të nxënësve/eve, aplikohet ose paralelisht ose e përcjell gjuhën e vendit (varësisht prej shtetit dhe gjuhës dhe specifikave të tjera lidhur me të).

Nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
16.14.1	Teksti shkollor është në përputhje me qëllimet dhe objektivat kurrikularë (të vendit të origjinës dhe të vendit ku jeton aktualisht nxënësja apo nxënësi).					
16.14.2	Teksti shkollor themelor, në kuptim të fushave dhe të përmbajtjeve kurrikulare, është i tipit të integruar (tekst ndërkurrikular).					
16.14.3	Edhe tekstet e një fushe a lënde (fletore apo separate tekstesh), njëkohësisht, janë konceptuar edhe brenda një integraliteti ndërveprues ndërkurrikular.					

16.14.4	Në aspektin tipologjik, teksti shkollor është mjaftueshëm problemor-krijues, e mbështet kërkimin dhe zbulimin (në funksion të të mësuarit krijues), është i përdorshëm për punë dhe në funksion të mbështetjes së përvetësimit dhe të zhvillimit të kompetencave të nxënësve/eve.					
16.14.5	Jo vetëm në plotësinë e tij, por edhe sipas zërave dhe fushave përkatëse (përmbajtjet, tekstet, ilustrimet dhe figurat si dhe njësitë tjera pamore dhe auditive), teksti shkollor është i konceptuar mjaftueshëm si mjet mësimor dhe medium nxitës dhe joshës.					
16.14.6	Teksti shkollor e mbështet pavarësinë e nxënësit/es, të qenit e tij subjekt i mësimin.					
16.14.7	Teksti shkollor i referohet mjaftueshëm një modeli të komunikimit sa konkret aq edhe diskret, shoqëruar posaçërisht me krijimin e kushteve dhe të hapësirës për lojë dhe argëtim (koncepti i shkollës/mësimin "lojë").					
16.14.8	Teksti i referohet realitetit dy apo shumëgjuhësor dhe dy apo shumëkulturor, ku ndërveprimi gjuhësor e kulturor favorizohet, dhe është në përputhje me qëllimet e objektivat kurrikulare.					
16.14.9	Në raport me gjuhën e kulturën e vendit si dhe institucionet e tij, teksti shkollor është i hapur, ndërveprues dhe afirmues.					
16.14.10	Teksti shkollor i referohet mjaftueshëm dhe me shembuj konkretë edhe mësimin kontrastiv (krahasues) dhe ndërveprimeve gjuhësore dhe kulturore.					
16.14.11	Abetarja apo plotësori i abetares me materialet përkatëse plotësuese është hartuar në përputhje me specifikat e gjuhës së vendit.					
16.14.12	Teksti shkollor u referohet mjaftueshëm kërkesave të diferencimit në mësim dhe individualizimit (shumësia dhe ndryshueshmëria e interesave, moshave, kompetencave etj.)					
16.14.13	Teksti shkollor shoqërohet me mjete dhe referenca të tjera të mjaftueshme mbështetëse multi/hiper mediale (CD, DVD, <i>e-learning</i> , softuerë etj.), përfshirë edhe mundësinë e bashkëveprimit me portalet përkatëse aktive virtuale.					
16.14.14	Si në aspektin e përmbajtjes, ashtu edhe në atë teknik-pamor teksti të nxënësit/et reflekton mjaftueshëm nga mesazhi edukativ i të qenit krenar për gjuhën, kulturën, origjinën dhe përshtatja me standardet vendore, në këtë rast, është e domosdoshme.					
16.14.15	Përveç si tekst shkollor themelor sipas cikleve (3+3), në rrethanat më të mira, ai është ndërtuar apo shoqëruar edhe me separate përkatëse, p.sh. të modelit të fletoreve të punës (sipas niveleve dhe kompetencave aktuale të nxënësve/eve, tërësive tematike apo parametrave tjerë diferencues-integrues)					

16.14.16	Përkrah patriotizmit dhe krenarisë së origjinës teksti shkollor reflekton vlera humanizmi e qytetarie, tolerancë qytetare, altruizëm e solidaritet njerëzor.					
16.14.17	Teksti shkollor i referohet mjaftueshëm punës (edhe të pavarur) të nxënësit/es, mësuesit/es, prindit apo kujdestarit/es tjetër dhe është shoqëruar apo pajisur me udhëzues përkatës didaktik-praktik.					
16.14.18	Teksti reflekton posaçërisht raport të përgjegjshëm dhe ndërveprues me shoqërinë vendore dhe vlerat e saj.					
16.14.19	Teksti paraqet një gjetje e zgjidhje të përshtatshme dhe optimale për punë me grupe/klasa, të cilat të shumtën janë të bashkuara (të kombinuara).					

**Vlera e përgjithshme për standardin 16.14 ({16.14.1 – 16.14.19}: 19) = \_\_\_\_\_**



## Formular përmbledhës:

### Vështrim i përgjithshëm, përmbledhës për tekstin shkollor:

.....

I vlerësuar nga; data: .....

Standardi nr.	Tregues (0 = i paplotësuar fare; 1 = i plotësuar jo mjaftueshëm; 2 = i plotësuar pjesërisht; 3 = i plotësuar mjaftueshëm; 4 = i plotësuar shkëlqyeshëm)	0	1	2	3	4
<b>A) Standarde të përgjithshme</b>						
Aspekte formale; paraqitja dhe pamja etj. (standardet 1 – 3)						
1	Përputhshmëria me kurrikulin dhe me tekstet shkollore s të së njëjtës lëndë të klasave pararendëse dhe vijuese					
2	Paraqitja, pamja, qartësia					
3	Ilustrimet					
Aspekte metodike dhe didaktike (standardet 4 – 8)						
4	Cilësia, relevanca dhe aktualiteti në pikëpamje përmbajtësore dhe shkencore					
5	Përshtatshmëria me moshën e nxënësve/eve					
6	Përpunimi dhe përpilimi didaktik					
7	Pyetjet dhe detyrat					
8	Aspekte gjuhësore					
Aspekte pedagogjike (standardet 9 – 12)						
9	Lidhjet me realitetin shoqëror, historik dhe politik					
10	Lidhjet me aspektet Edukim për pjekuri/pavarësi; Edukim për demokraci; Edukim paqësor					
11	Reflektimi i barazisë gjinore					
12	Përmbajtja ndërkurrikulare të tjera të rëndësishme					
Aspekte të praktikës pedagogjike (standardet 13 – 15)						
13	Doracak për mësimdhënësit/et; përdorshmëria e tij					
14	Materiale pune (ushtrime etj.) në lidhje me tekstin shkollor					
15	Sprovimi/testimi praktik, paraprak, i tekstit shkollor					
<b>B) Standardi plotësues sipas lëndës</b>						
16						

### Komentar përmbledhës, përfundimtar (në fletë shtesë)

- Vlerësimi i përgjithshëm i tekstit shkollor; vlerat dhe dobësitë e tij
- Pikënisjet kryesore të përmirësimit/përpunimit
- (Eventualisht): Rekomandim lidhur me lejimin/miratimin zyrtar të tekstit shkollor

## Shtojcë1: Bibliografi

- aap (Association of American Publishers, Inc.; School Division) (o.D.): Èhat it Takes to Publish a Quality Textbook. o.O. (Link: [www.publishers.org/SchoolDiv/research/research\\_01\\_Brochures.htm](http://www.publishers.org/SchoolDiv/research/research_01_Brochures.htm))
- Becker, Gerold, et alii (ed.; 2005): Standards. Unterrichten zëischen Kompetenzen, zentralen Prëfungen und Vergleichsarbeiten. (= Friedrich Jahresheft XXIII)
- Bollmann, Brigitte; Berëeger, Simone (2008): Prozessbericht zum internen Projekt «Vorprojekt: Begleitevaluation zur Entëicklung des neuen Mathematiklehrmittels Sekundarstufe I». Zürich (i pabotuar)
- Braslavsky, C. (ed.) (2006). Textbooks and Quality Learning for All: Some lessons learned from International Experiences. (Link: [Braslavsky, C. \(ed.\) \(2006\): Textbooks and Quality Learning for All: Some lessons learned from International Experiences. Paris \(UNESCO\). \(Link: - http://www.ibe.unesco.org/en/services/publications/studies-in-comparative-education.html\)](http://www.ibe.unesco.org/en/services/publications/studies-in-comparative-education.html))
- Bruillard, Eric u.a. (ed., 2006): Caught in the Èeb or Lost in the Textbook? Conference volume, Paris (Link: [www.caen.iufm.fr/colloque\\_iartem/pdf/part\\_II.pdf](http://www.caen.iufm.fr/colloque_iartem/pdf/part_II.pdf))
- Chebutek Rotich, Daniel; Joseph Musakali (2006): Evaluation and Selection of School Textbooks in Kenya: The Role of the Ministerial Textbook Vetting Committee. Në: Eric Bruillard et alii (ed.), f. 349-360
- Council of Europe/Europarat (pa datë.): Common European Frameëork of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment. Link: [www.coe.int/T/DG4/Linguistic/CADRE\\_EN.asp#TopOfPage](http://www.coe.int/T/DG4/Linguistic/CADRE_EN.asp#TopOfPage)
- Erziehungsdepartement des Kantons Basel Stadt, Ressort Schulen (2006): Sprachprofile für die Volksschule Basel Stadt. Basel (ED BS)
- Exarhos, Ioannis (2006): Greek primary teachers' preferences for and characteristics of science textbooks. Në: Eric Bruillard et alii, f. 371-380
- Georg Eckert Institut für internationale Schulbuchforschung (pa datë): Erdkundelehrërke rezensieren – Tipps und Anregungen. / Geschichtslehrërke rezensieren – Tipps und Anregungen / Politiklehrërke rezensieren – Tipps und Anregungen. (Link: [www.gei.de/index.php?id=schulbuchrezensionen&L=0](http://www.gei.de/index.php?id=schulbuchrezensionen&L=0))
- Georgescu, Dakmara (pa datë): Tool: Elements of a textbook policy for Afghanistan (dokument për përdorim të brendshëm të UNESCO-së)
- Georgescu, Dakmara; Jean Bernard (2007): Thinking and Building Peace Through Innovative Textbook Design. Paris: UNESCO
- Gim, Chaechun (2006): A Critical Revieë of Textbook Authorization System in the Republic of Korea. Në: Eric Bruillard et alii, f. 381-392
- ilz (interkantonale Lehrmittelzentrale) (2008): Entëurf für eine Checkliste «Qualitätskriterien für Lehr- und Lernmittel» (dokument i brendshëm, i pabotuar)
- Johnsson Harrie, Anna (2006):The Sëedish State Approval of Textbooks 1974-1991. Në: Eric Bruillard et alii, f. 361-369
- Klett und Balmer Verlag AG (2003): Kriterienkatalog für nicht-sexistische Lehrmittel. (Dokument i brendshëm, i pabotuar)
- Lasnier, Jean-Claude et alii (2003): Qualitätsleitfaden zur Beëertung und Entëicklung von Programmen und Materialien zum Sprachenlernen und -lehren; Version 2003. Bruksel (DG Education and Culture) (DVD në disa gjuhë)
- Lehrmittelkommission des Kantons Aargau (2007): Instrument zur Beurteilung und Evaluation von Lehrmitteln (i pabotuar, dokument për përdorim të brendshëm)
- McCall, James (2006): Textbook Evaluation in East Africa: some practical experiences. Në: Eric Bruillard et alii, f. 393-398
- Ministarstvo prosvjete i sporta [i Republikës së Kroacisë] (2003): Udzbenicki standard. Zagreb (dokument për përdorim të brendshëm)
- Ministria e Arsimit, shkencës dhe teknologjisë [e Kosovës] (2007): Strategy for development of pre-university education in Kosovo 2007-2017. Prishtina (Link (shqip): [www.masht-gov.net/advCms/](http://www.masht-gov.net/advCms/))
- Ministria për Arsim dhe Shkencë [e Republikës së Maqedonisë] (2006): Konceptioni për tekst shkollor të arsimet fillor dhe të mesëm. Manastir: SHA "Kiro Dandaro"

- Nodari, Claudio (1995): Perspektiven einer neuen Lehrerekkultur. Aarau/Fft.M/Salzburg (Sauerländer)
- Nodari, Claudio (1997): Anforderungsprofil für eine neue Lehrerekkgeneration von Französischlehrmitteln für Volksschulen. (i pabotuar)
- Nodari, Claudio (1999): Kriterien zur Gestaltung autonomiefördernder Lehrereke. Në: Theorie und Praxis. Österreichische Beiträge zu Deutsch als Fremdsprache, 3/1999, f. 200-213
- Nogova, Maria; Jana Huttova (2006): Process of Development an Testing on Textbook Evaluation Criteria in Slovakia. Në: Eric Bruillard et alii, f. 333-340
- NË EDK, Projektbearbeitung Esther Sauer (2004): Passerelle, Sockelkonzept. Entëicklung neuer Lehr- und Lernmaterialien für die integrierte Sprachförderung und den Fremdsprachenunterricht. (i pabotuar; Link: [ëëë.ag.ch/nëedk/shared/dokumente/pdf/passerelle.pdf](http://www.see.ag.ch/nëedk/shared/dokumente/pdf/passerelle.pdf))
- Oelkers, Jürgen (2004a): Stellenëert der Lehrmittel in einem modernen Bildungsëesen. Vortrag anlässlich der 61. Delegiertenkonferenz der Interkantonalen Lehrmittelzentrale ilz am 18. Juni 2004 im Hotel-Restaurant UTO KULM in Zürich-Uetliberg (mund të gjendet në internet te: Oelkers, Stellenëert der Lehrmittel)
- Oelkers, Jürgen (2004b): Fossilien der Didaktik? Ein Blick in die Geschichte von Lehrmitteln. Vortrag auf der ILIAS-Konferenz am 30. September [2004] in der Pädagogischen Hochschule Zürich (mund të gjendet në internet te: Oelkers, Fossilien der Didaktik)
- Oelkers, Jürgen (2004c): Lehrmittel als Rückgrat des Unterrichts. Vortrag vom 4. Sept. 2004 in Zürich (mund të gjendet në internet te: Oelkers, Lehrmittel als Rückgrat)
- Paradigm, Journal of the Textbook Colloquium (div. Hefte ab 1989; Link: <http://faculty.ed.uiuc.edu/ëestbury/Paradigm/>)
- phAkzente 2/2005: Schëerpunktsheft Bildungsstandards
- phAkzente 4/2004: Schëerpunktsheft Lehrmittel
- Pingel, Falk (o.D. [1999]): UNESCO Guidebook on Textbook Research and Textbook Revision. Link: [http://portal.unesco.org/education/en/ev.php-URL\\_ID=53469&URL\\_DO=DO\\_TOPIC&URL\\_SECTION=201.html](http://portal.unesco.org/education/en/ev.php-URL_ID=53469&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html)
- Regionalsekretariat BKZ (2007): Fragebogen zur Evaluation von Sprachbüchern. (i pabotuar)
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (2006): Urdhër për krijimin e bordit të miratimit të teksteve shkollore (nr. 108, 28.3.2006) (Link: [ëëë.mash.gov.al/kurikulat/TEKSTET.HTML](http://www.mash.gov.al/kurikulat/TEKSTET.HTML))
- Strittmatter, Anton (1988): Èas ist ein «gutes Lehrmittel»? Në: Schëeiz. Lehrerzeitung nr. 133, f. 37-43
- UNESCO, Education Sector; Division for the Promotion of Quality Education; Section of Education for Peace and Human Rights (Hrsg.; 2005): A Comprehensive Strategy for Textbooks and Learning Materials. Paris (UNESCO) (als pdf auf [http://portal.unesco.org/education/en/ev.php-URL\\_ID=45690&URL\\_DO=DO\\_TOPIC&URL\\_SECTION=201.html](http://portal.unesco.org/education/en/ev.php-URL_ID=45690&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html))

## Linke

- [http://en.ëikibooks.org/ëiki/Èikibooks:Textbook\\_Standards](http://en.ëikibooks.org/ëiki/Èikibooks:Textbook_Standards)
- [ëëë.iartem.no/](http://www.ëëë.iartem.no/) (IARTEM, The International Association for Research on Textbooks and Educational Media)
- [ëëë.gei.de](http://www.ëëë.gei.de/) (Georg Eckert Institut für internationale Schulbuchforschung)
- [ëëë.open.ac.uk/Arts/TEXTCOLL/](http://www.ëëë.open.ac.uk/Arts/TEXTCOLL/) (The Textbook Colloquium)
- [ëëë.ibe.unesco.org/en.html](http://www.ëëë.ibe.unesco.org/en.html) (Unesco, international bureau of education)
- [http://portal.unesco.org/education/en/ev.php-URL\\_ID=53410&URL\\_DO=DO\\_TOPIC&URL\\_SECTION=201.html](http://portal.unesco.org/education/en/ev.php-URL_ID=53410&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html)
- [ëëë.quiltnetëork.org](http://www.ëëë.quiltnetëork.org/) (QUILT = Quality in Language Teaching/Learning)

## **Shtojcë 2:           Lista e hartues/eve të standardeve dhe e bashkëpunëtorëve**

### **Këshilli mbikëqyrës:**

Enver Buçaj, sekretar i hershëm në MASHT

Nehat Mustafa, këshilltar i ministrit në MASHT

Agim Bërdyna, drejtor i Departamentit të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar në MASHT

Ramush Lekaj, udhëheqës i Sektorit të Sigurimit të Cilësisë në MASHT

### **Koordinatorët:**

Basil Schader

Arif Demolli

Hajrije Devetaku

Nuhi Gashi

### **Ekspertët nga Kosova:**

Arbër Salihu

Besa Luzha

Fehmi Krasniqi

Feime Llapashtica

Fetah Bylykbashi

Fetah Podvorica

Fevzi Berisha

Ilaz Zogaj

Kimete Dida

Kujtim Rrahmani

Mire Gashi

Muhamet Ahmeti

Nehar Shishko

Nezir Berisha

Ragip Rrustemi

Rasim Bejtullahu

Rexhep Kastrati

Shemsi Krasniqi

Beqir Hasangjekaj

Shqipe Gashi

Shukri Maxhuni

Shykrane Gërmizaj

Skënder Berani

Xhabir Hajredinaj

### **Ekspertët nga Zvicra:**

Ann Peyer

Bernhard Keller

Claudia Neugebauer

Claudio Nodari  
Dieter Isler  
Moritz Rosenmund  
Thomas Bachmann  
Ursina Gloor